

PUNET' E APOSTOJVET

Krye 1

¹ Fjalën' e-parë, o Theofil, e bëra për gjithë sa zuri Jisuj të bënë e të mësonjë,
² Gjer mb'atë ditë që hipi lart **ndë qiellit**, pasi me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë u la porosi apostojvet që pat sgjedhurë; ³ Mbë të-cilët edhe e dëfteu vetëhen' e ti të-gjallë me shumë shënja pas të-pësuarit të ti, dyke dukurë ndër ata dyzet dit, e dyke folurë për punët' e mbretëris' së Perëndisë. ⁴ Edhe dyke umbledhurë bashkë me ata i porositi të mos ndahenë nga Jerusalemi, po të presenë të-zotuarët e Atit, që dëgjuatë, **u tha**, prej meje. ⁵ Sepse Joani pagëzoi me ujë, po ju dotë pagëzoheni me Frymë të-Shënjtëruarë jo pas shumë ditve pas këtyre.

⁶ Ata pra kur umblohnë bashkë me atë **mbë një vënt**, e pyesninë, dyke thënë, Zot, vallë mbë këtë kohë dot'j'a apç mbretërinë Israilit? ⁷ Edhe ay u tha atyre, Nuk' është puna juaj të njihni kohërat' a motetë, të-cilëtë i ka vënë Ati ndë pushtett të ti; ⁸ Po dotë merrni fuqi, kur të vinjë Frym' e-Shënjtëruarë mbi ju; edhe dotë më jeni dëshmitarë edhe ndë Jerusalem edhe ndë gjithë Judhet edhe ndë Samarit edhe gjer ndë funtt të dheut.

⁹ Edhe si tha këto, tek po shihninë ata ungrit lart, edhe një re e mori nga syt' e atyreve. ¹⁰ Edhe **ata** tek ishinë dyke vështruarë ndë qiellit, kur po shkote ay **lart**, na dy burra me rroba të-bardha tek qëndruanë për'an' atyreve; ¹¹ Të-cilëtë edhe **u** thanë, O burra Galileas, përse rrii e vështroni ndë qiellit? ky Jisuj që hipi prej jush lart ndë qiellit dotë vinjë kështu, sikundrë e patë atë dyke vajturë ndë qiellit.

¹² Atëhere ukthyenë ndë Jerusalem nga mali që thuhetë Ullishte, i-cili është afërë Jerusalemit, edhe mban lark **sa** një udhë së-shëtune. ¹³ Edhe kur hynë, hipnë ndë dhomët të-sipërme, ku kishinë të-ndënjuritë Pjetri e Jakovi e Joani e Andreu, Filippi edhe Thomaj, Varthollomeu edhe Matheu, Jakovi **i bir'** i Alfeut edhe Simon Zillotiu, edhe Judha **i vëllaj** i Jakovit. ¹⁴ Këta të-gjithë ishinë dyke qëndruarë me një zëmërë mbë të-falurit e mbë të-luturit, bashkë me gratë, edhe me Mariënë t'ëmën' e Jisujt, edhe bashkë me të vëllezërit' e ati.

¹⁵ Edhe ndër këto dit ungrit Pjetri ndë mest të nxënëset, e tha, (edhe shumic' e të-mbledhurëvet atje ishinë sindonja një qint e një-zet **veta**.)

¹⁶ O burra vëllezër, duhej të mbushej këjo shkronjë, të-cilënë e tha më përpara Frym' e-Shënjtëruarë me anë të Dhavidhit për Judhënë që ubë udhëheqës i atyreve që zunë Jisunë; ¹⁷ Sepse qe i-numëruarë bashkë me ne, edhe pat marrë pjesën' e kësaj shërbese.

¹⁸ Ky pra fitoj një arë nga pag' e paudhërisë, edhe dyke rënë përmbys plasi ndë mest, edhe i uderthnë gjithë të-përbrëndëshmetë; ¹⁹ Edhe këjo ubë e-diturë ndër gjith' ata që rrininë ndë Jerusalem, kaqë sa ajo arë uquajt ndë gjuhët t'atyreve Akeldhama, që do me thënë, Arë gjaku.

²⁰ Sepse është shkruarë ndë vivilit të Psallmavet, "Ushkretoftë shtëpia e ati edhe mos ndënjtë njeri nd'atë;" edhe, "Tjetërë e marrtë punën' e ati". ²¹ Duhetë pra nga ata burratë që umblohnë bashkë me ne tërë kohënë, ndë të-cilëtë Zoti Jisu hyri e doli ndër ne, ²² Dyke zënë që nga pagëzimi i Joanit e gjer mb'atë ditë ndë të-cilëtë hipi lart prej nesh, një nga këta të bënë të dëshmitar bashkë me ne për të-ngjallurit' e ati.

²³ Edhe ndanë dy **veta**, Josifnë që quhej Varsava, i-cili upërmbiquajt Just, edhe Matthinë. ²⁴ Edhe dyke falurë thanë, Ti, o Zot, zëmërë-njohës i të-gjithëve, dëfte një nga këta të dy, atë që ke sgjedhurë, ²⁵ Që të marrë pjesën' e kësaj shërbese e

apostolie, prej së cilësë ra Judha, që të vejë ndë vëntt të ti. ²⁶ Edhe u dhan' atyre shorta; edhe shorta i ra Matthisë, edhe unumërua bashkë me të një-mbë-dhjetëtë apostoj.

Krye 2

¹ Edhe kur erdhi dit' e Pendikosisë, ishinë të-gjithë me një zëmërë mbë një vënt. ² Edhe papriturë ubë një oshëtimë nga qielli posi **oshëtima** e një ere që fryn me fuqi, edhe mbushi gjithë shtëpinë tek ishinë dyke ndënjurë. ³ Edhe udukne mb'ata gjuhëra dyke undarë posi prej zjarri, edhe ndënjën mbë gjithë-sicilinë nga ata. ⁴ Edhe umbushnë të-gjithë me Frymë të-Shënjtëruarë, e zunë të flisninë me gjuhëra të-tjera, sikundrë Fryma u epte të flisninë.

⁵ Edhe ishinë dyke ndënjurë ndë Jerusalem Judhenj, burra me frikë Perëndie prej çdo kombi ndënë qiellit. ⁶ Edhe kur ubë ky zë, umbloth gjindja edhe utrumbullua; sepse gjithë-sicili **nga ata** dëgjonte ata dyke folurë ndë gjuhët të ti. ⁷ Edhe të-gjithë maniteshin' e çuditeshinë, dyke thënë njeri tjetërit, Na, nukë janë Galileas këta të-gjithë që flasënë? ⁸ Edhe qysh gjithë-sicili nga ne dëgjojmë ndë gjuhët t'ënë, ndë të-cilët kemi lindurë? ⁹ Parthë e Midhë e Ellamitë, edhe ata që rrinë ndë Mesopotamit e ndë Judhet e ndë Kappadohqit, ndë Pontt e nd'Asit, ¹⁰ Ndë Frygjit e ndë Pamfilit, nd'Egjyptët e nd'anët të Livisë përënë Qyrinësë, edhe të-ardhuritë nga Roma Judhenj e të-kthyerë, ¹¹ Kritas e Arapë, dëgjojm' ata dyke folurë ndë gjuhërat t'ona madhëriat' e Perëndisë. ¹² Edhe të-gjithë maniteshinë edhe vrisninë mëndjenë dyke thënë njeri tjetërit, Vallë ç'dotë jetë këjo? ¹³ Edhe të-tjerë dyke përqeshurë thoshinë, Se janë mbushurë me verë t'ëmbëlë.

¹⁴ Po Pjetri qëndroj bashkë me të një-mbë-dhjetëtë, edhe ngriti zën' e ti edhe u ligjëroj atyre,

O burra Judhenj edhe gjithë sa rrini ndë Jerusalem, letë jet' e-diturë këjo ndër ju, e vi-u-ni veshnë fjalëvet të mia. ¹⁵ Sepse këta nukë janë të-dejturë, sikundrë pandehni ju; sepse **tashit** është or' e-tret' e ditësë; ¹⁶ Po këjo është ajo që është thënë me anë të profitit Joil: ¹⁷ "Edhe ndë ditt të-pastajme, thotë Perëndia, dotë derth nga Fryma ime mbë çdo mish; edhe dotë profitepsenë bijtë t'uaj edhe bijatë t'uaj, edhe djaloshëtë t'uaj dotë shohënë të-fanitura, edhe pleqtë t'uaj dotë ëndërrinjë në ëndërra; ¹⁸ Edhe mbi shërbëtorët të mi edhe mbi shërbëtorët të mia nd'ato dit dotë derth nga Fryma ime; edhe dotë profitepsenë; ¹⁹ Edhe dotë bënë çudira lart ndë qiellt edhe shënja poshtë mbi dhet, gjak e zjarr e avullë tymi; ²⁰ Djelli dotë kthenetë mb'errësirë, edhe hëna mbë gjak, para se të vinjë e-madhja e e-çquara dit' e Zotit. ²¹ Edhe kushdo që të thërresë mb'emërit të Zotit, dotë shpëtonjë."

²² O burra Israilitë, pa dëgjoni këto fjalë; Jisu Nazoreasinë, njeri të-dëftyerë mbë ju nga Perëndia me fuqira e me çudira e me shënja, të-cilatë bëri Perëndia me anë t'ati ndër mest t'uaj, sikundrë edhe vetë e dini, ²³ Këtë që qe dhënë pas ëndës' s'urdhëruarë edhe pas parënjotjes' së Perëndisë **ju** e zutë edhe me duar paudhërie e mbërthyetë edhe e vratë; ²⁴ Këtë Perëndia e ngjalli, passi sgidhi dhëmbjet' e-këqia të vdekjesë, sepse nukë munt të mbahej ay prej asaj. ²⁵ Sepse Dhavidhi thotë për atë, "Shihnam Zotinë përpara meje gjithënjë, sepse është prej së-djathtësë s'ime, që të mos tundem. ²⁶ Përandaj ugëzua zëmëra ime, edhe gjuha ime ugazëllua; po edhe mishi im dotë prëhetë mbë shpresë. ²⁷ Sepse nukë dotë lësh shpirtinë t'im ndë hadht, as dotë lësh Shënjtinë t'ënt të shohë prishje. ²⁸ Më dëfteve udhë jete; dotë më mbushç gëzim me faqenë t'ënde."

²⁹ O burra vëllezër, munt t'u them me kuxim për krye-atinë Dhavidh, se **ay** edhe vdiq edhe ukall ndë varr, edhe varr' i ati është ndër ne gjer mbë këtë ditë. ³⁰ Po dyke qënë profit, edhe dyke diturë se Perëndia me be i upërgjërue, se nga pema

e mezit t'ati, pas mishit, dotë ngjallnjë Krishtinë, që t'a vërë të rrijë mbi front t'ati, ³¹ E pa që më përpara edhe foli për të-ngjallurit' e Krishtit, se shpirti i ati nuk' ula ndë hadht, as mishi i ati nukë pa prishje. ³² Këtë Jisu e ngjalli Perëndia, për të-cilinë neve të-gjithë jemi dëshmitarë. ³³ Si ungrit pra lart me **dorën'** e-djathhtë të Perëndisë, edhe mori nga Ati të-zotuarët' e Frymës' së-Shënjtëuarë, derdhi këtë që ju ndashti shihni e dëgjoni. ³⁴ Sepse Dhavidhi nukë hipi ndë qiejt; po ay thotë, "I tha Zoti Zotit t'im, Rri prej së-djathësë s'ime, ³⁵ Gjersa të vë armiqt' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet të tua."

³⁶ Let'a dijë pra fort mirë gjithë shtëpia e Israilit, se këtë Jisunë, të-cilinë ju e kryqëzuatë, Perëndia e bëri Zot edhe Krisht.

³⁷ Edhe si dëgjuanë **këto**, umallënyenë ndë zëmëret, edhe i thanë Pjetrit edhe apostojvet të-tjerë, Ç'të bëjmë, o burra vëllezër?

³⁸ Atëhere Pjetri u tha atyre, Pendohi, edhe gjithëkush prej jush letë pagëzonetë mb'emërit të Jisu Krishtit, për ndjesën' e fajevet; edhe dotë merrni dhurëtin' e Frymës' së-Shënjtëuarë; ³⁹ Sepse të-zotuarët' është mbë ju edhe mbë djemtë t'uaj, edhe mbë gjith' ata **që janë** lark, sa ka për të thirrurë Zoti Perëndia ynë.

⁴⁰ Edhe me shumë fjalë të-tjera dëshmonte edhe i nguste **ata**, dyke thënë, Shpëtoni nga ky bres i-shtrëmbërë.

⁴¹ Ata pra që pritnë me gëzim fjalën' e ati upagëzuanë; edhe atë ditë ushtuanë sindonja tri mijë shpirtë.

⁴² Edhe ishinë dyke priturë ndë mësimt të apostojvet, e ndë shoqërit, e ndë të thyerët të bukësë, e ndë të-falurat. ⁴³ Edhe çdo shpirti i hyri frikë; edhe shumë çudira e shënja bëneshinë me anë t'apostojvet. ⁴⁴ Edhe gjith' ata që besoninë ishinë bashkë, edhe të-gjitha i kishinë të-bashkëta. ⁴⁵ Edhe shisninë kamjet' e gjënë, e i ndaninë ndëpër të-gjithë, sipas nevojësë që kishte gjithë-sicili. ⁴⁶ Edhe përdita ishinë dyke priturë me një zëmërë ndë hieroret, e thyeninë bukë prej shtëpie mbë shtëpi, e haninë me gëzim e me kthjelltësirë zëmëre, ⁴⁷ Dyke lavduruarë Perëndinë, e dyke pasurë hir përpara gjithë llauzit. Edhe Zoti shtonte përdita ndë kishët ata që shpëtoninë.

Krye 3

¹ Edhe Pjetri e Joani po hipninë bashkë ndë hieroret ndë të-falurit mbë të-nënttënë orë. ² Edhe një njeri që ishte i-çalë që nga barku i s'ëmësë po e sillninë; këtë e vininë përdita ndë derët të hieroresë që thuhej e-Bukurë, që të lypente eleimosinë nga ata që hyninë ndë hieroret. ³ Ky, kur pa Pjetrin' edhe Joaninë se dotë hyninë ndë hieroret, lypete të marrë eleimosinë **nga ata**. ⁴ Po Pjetri bashkë me Joaninë shtyri sytë mb'atë e tha, Shiko mbë ne. ⁵ Edhe ay i shikonte ata me kujdes, dyke shpëryerë të marrë gjësendi nga ata. ⁶ Atëhere Pjetri tha, Ergjënt edhe ar nukë kam; po atë që kam, këtë t'a ap; Mb'emërit të Jisu Krisht Nazoreasit, ngreu edhe ecë. ⁷ Edhe si e kapi atë prej dorës' së-djathhtë e ngriti; edhe për-një-here i uforcuanë gjurmët' e koçkorët' **e këmbëvet**; ⁸ Edhe dyke kërcyerë përpjetë qëndroj **mbë këmbë** edhe ecënte; edhe hyri bashkë me ata ndë hieroret, dyke ecur' e dyke kërcyer' e dyke lavduruarë Perëndinë. ⁹ Edhe gjithë llauzi e pa atë dyke ecur' e dyke lavduruarë Perëndinë. ¹⁰ Edhe e njihnin' atë, se ky ishte ay që rrinte mbë derët të-Bukurë të hieroresë për eleimosinë; edhe umbushnë me të-çuditur' e me të-habiturë për këtë **punë** që i gjau ati.

¹¹ Edhe tek mbante i-çali që ushërua Pjetrin' edhe Joaninë, gjithë llauzi rrudhi pas atyreve ndë kamaret që quhet' e Sollomonit, dyke habiturë.

¹² Edhe Pjetri kur pa, i upërgjeq llauzit,

O burra Israilitë, përse çuditëni për këtë **punë**? apo përse shtini sytë mbë ne, sikurse **ne** me fuqinë **t'ënë** a me besënë t'ënë e kemi bërë këtë **njeri** të ecënjë?

¹³ Perëndia i Avramit edhe i Isaakut edhe i Jakovit, Perëndia i atërvet t'anë, lavduroj Birin' e ti Jisu, të-cilinë ju e dhatë ndër duar, edhe e mohuatë përpara Pillatit, ndonëse ay e pa të udhësë t'a lëshonte. ¹⁴ Po ju mohuatë Shënjinë edhe të-Drejtinë, edhe kërkuatë t'u epetë juve një burrë vrasës; ¹⁵ Edhe **kështu** vratë Kryen' e jetësë, **po** të-cilinë Perëndia e ngjalli prej së-vdekurish, të-cilit ne jemi dëshmitarë. ¹⁶ Edhe me anë të besësë mb'emërit' t'ati, këtë që shihni edhe e njihni, emër' i ati e forcoj; edhe besa që është me anë t'ati i dha këti shëndet të-plottë përpara gjithë jush.

¹⁷ Edhe ndashti, o vëllezër, e di se e punuatë nga paditja, sikundër edhe të-parëtë t'uaj. ¹⁸ Po Perëndia sa tha që përpara me anë të gojës' së gjithë profitërvet të ti, se Krishti kishte për të pësuarë, i mbushi kështu.

¹⁹ Pendohi pra edhe kthehi, që të shuhenë fajetë t'uaj, që të vinjën kohëra të-prëjturi prej faqes' së Zotit, ²⁰ Edhe të dërgonjë Jisu Krishtinë, që është lëçiturë që përpara mbë juve; ²¹ Të-cilinë duhetë t'a mbanjë qielli gjer mb'ato kohëra që dotë vinjën mbë vënt gjith' ato që foli Perëndia që ndë kryet të jetësë me anë të gojës' së gjithë shënjtorëvet të ti profitër.

²² Sepse Moisiu u tha atërvet, "Se Zoti Perëndia dotë ngrerë ndër ju nga vëllezëritë t'uaj një profit posi mua; ati t'i dëgjoni mbë të-gjitha sa që t'u flasë juve; ²³ Edhe çdo shpirt që të mos i dëgjonjë ati profiti, dotë shuhetë nga llauzi." - ²⁴ Edhe gjithë profitëritë sa folnë që nga Samuili e paskëtaj dhanë zë (që përpara) edhe për këto dit. ²⁵ Ju jeni bijt' e profitërvet, edhe të dhjatësë që bëri Perëndia me atëritë t'anë, dyke thënë Avramit, "Edhe ndë farët t'ënde dotë bekonenë gjithë kombet' e dheut." ²⁶ Te ju më parë Perëndia, passi e ngjalli Birin' e ti Jisu, e dërgoj që t'u bekojë juve, dyke kthyerë gjithë-sicilinë **prej jush** nga ligësitë t'uaj.

Krye 4

¹ Edhe tek po ishinë ata dyke folurë llauzit, erthnë mbi ata profitërit' edhe i-par' i hieroresë edhe Sadduqenjët, ² Dyke uzëmëruarë, sepse mësoninë llauzinë, edhe lëçitninë të-ngjalluritë prej së-vdekurish me anë të Jisujt; ³ Edhe vunë duartë mbi ata, edhe i vunë ndënë ruajtje gjer mbë të-nesërmet; sepse më ishte ndaj të-ngrysurë. ⁴ Edhe shumë **veta** nga ata që dëgjuanë fjalënë besuanë; edhe ubë numri i njerëzet sindonja pesë mijë.

⁵ Edhe mbë të-nesërmet umblohnë ndë Jerusalem të-parët' e atyreve edhe pleqt' edhe shkronjësitë, ⁶ Edhe Anna kryepriifti e Kaiafia e Joani e Aleksandri, edhe gjithë sa ishinë prej fare kryepriiftërie. ⁷ Edhe si i vunë ata ndë mest, i pyesninë, Me ç'farë fuqie, e me ç'farë emëri e bëtë këtë ju? ⁸ Atëhere Pjetri umbush me Frymë të-Shënjtëruarë, e u tha atyre, O të-parët' e llauzit, edhe **ju** pleqt' e Israilit, ⁹ Ndë qoftë se neve pyetemi sot për një të-mirë **që ubë** mbë njeri të-sëmurë, me ç'farë **fuqie** ushërua ky, ¹⁰ Letë jetë e-diturë mbë gjithë ju edhe mbë gjithë llauzin' e Israilit, se mb'emërit të Jisu Krisht Nazoreasit, të-cilinë ju e kryqëzuatë, **po** të-cilinë Perëndia e ngjalli prej së-vdekurish, me anë të këti qëndron ky **ndashti** përpara jush i-shëndoshë. ¹¹ Ky është guri që s'uzu për gjë prej jush që ndërtoni, i-cili ubë krye çipi. ¹² Edhe nukë ka shpëtim me anë të asndonjë tjetëri; sepse as tjetërë emërë ndënë qiellit s'është dhënë ndër mest të njerëzet, me anë të të-cilit duhetë të shpëtojme.

¹³ Edhe dyke vështruarë kuximn' e Pjetrit edhe të Joanit, edhe dyke kupëtuarë, se ishinë njerës të-paditurë edhe prej dorës' së-poshtërë, çuditëshinë, po i njihninë se kishinë qënë bashkë me Jisunë. ¹⁴ Edhe si shihninë të-shëruarinë njeri dyke ndënjurë bashkë me ata, s'kishinë seç të thoshinë kundër. ¹⁵ Atëhere urdhëruan' ata të dalënë jashtë bashkë-ndënjesë, edhe dhan' e muarrë ndër mest të tyre, ¹⁶ Dyke thënë, Ç'tu bëjmë këtyre njerësve? sepse ubë një e-shënuarë çudi me

anë t'atyreve, **kjo** është e-çfaqurë mbë gjith' ata që rrinë ndë Jerusalem, edhe nukë munt t'a mohojmë; ¹⁷ Po që të mos përhapetë më tepërë ndë mest të llauzit, let'i frikësojmë ashpërë, që të mos i flasënë më mbë këtë emërë asndonjë njeriu.

¹⁸ Edhe i thërritn' e i porositnë të mos flasënë asfare, as të mos mësonjënë mb'emërit të Jisujt. ¹⁹ Po Pjetri e Joani u upërgjeqnë atyreve, e u thanë, Ndë është e udhësë përpara Perëndisë t'u dëgjojmë juve më tepërë se Perëndisë, gjykoni. ²⁰ Sepse ne nukë muntmë të mos flasëmë për sa pam' e dëgjuamë. ²¹ Edhe ata, si i frikësuanë përsëri, i lëshuanë, sepse nukë gjeninë, se qysh t'i mundonin' ata, për llauzinë; sepse të-gjithë lavduroninë Perëndinë për atë që ubë. ²² Sepse njeriu, mbë të-cilinë ubë këjo çudi e shërimit, ishte më tepërë se dyzet vjeç.

²³ Edhe si ulëshuanë, erthnë te të-tyretë, edhe dhanë zë për gjithë sa u than' atyreve kryepriiftërit' edhe pleqtë. ²⁴ Edhe ata kur dëgjuanë, me një zëmërë ngritnë zënë mbë Perëndinë, edhe thanë, O zotëri, ti **je** Perëndia, që bërë qiellin' edhe dhenë edhe detinë, edhe gjithë sa janë nd'ata; ²⁵ **Ti** që ke thënë me anë të gojës' së shërbëtorit t'ënt Dhavidh, "Përse çfrytnë kombetë edhe shkuanë ndër mënt **punëra** të-kota? ²⁶ Mbretërit' e dheut ndënjnë kundrë Zotit, edhe kundrë të-Lyerit t'ati." ²⁷ Sepse me të-vërtetë umblothnë kundrë shënjtit djalit t'ënt Jisu, të-cilinë e leve **me vaj**, edhe Irodhi edhe Pondiu Pilat bashkë me kombet' e me llauzet' e Israilit, ²⁸ Që të bënëjënë gjithë sa urdhëroj që përpara dora jote edhe këshilla jote të bënenë. ²⁹ Edhe tashi, o Zot, vështro ndë të-frikësuarat t'atyre, edhe ep-u shërbëtorëvet të tu të flasënë fjalënë t'ënde me çdo kuxim, ³⁰ Dyke sgjaturë dorënë t'ënde të bënenë shërime e shënja e çudira mb'emërit të shënjtit djalit t'ënt Jisu.

³¹ Edhe si ulutnë ata, utunt vëndi ku ishinë mbledhurë, edhe umbushnë që të-gjithë me Frymë të-Shënjtëruarë, edhe flisinë fjalën' e Perëndisë me kuxim.

³² Edhe zëmëra e shpirti i shumicës' s'atyreve që kishinë besuarë ishte një; edhe asndonjë nukë thoshte për ndonjë gjë nga pasjet' e tia se është' e tia, po të-gjitha i kishinë të-bashkëta. ³³ Edhe me fuqi të-madhe epnin' apostojtë dëshmimin' e të-ngjallurit të Zotit Jisu; edhe hir i-math ishte mbë gjith'ata. ³⁴ Sepse asndonjë ndër mest t'atyre ishte ndë nevojë; sepse gjithë sa kishinë ara a shtëpira, i shisnin' edhe bininë të-çëmuarat' e atyre që shisinë, ³⁵ Edhe i vininë ndër këmbët t'apostojvet; edhe i epninë gjithë-sicilit sipas nevojësë që të kishte.

³⁶ Edhe Josiu, i-cili prej apostojvet upërmbyqajit Varnavë (që këjo e-kthyerë do me thënë, Bir ngushëllimi), i-cili ishte Levit Qyprian nga kombi, ³⁷ Shiti një arë që kishte, edhe pruri aspratë e i vuri ndër këmbët t'apostojvet.

Krye 5

¹ Po një burrë që e kishte emërinë Anani, bashkë me gruan' e ti Sapfirë, shiti një gjë; ² Edhe fshehu nga të-çëmuarët, **dyke ditur'** edhe gruaja e ti; edhe pruri një pjesë **nga aspratë**, edhe e vuri ndër këmbët t'apostojvet. ³ Po Pjetri tha, Anani, përse mbushi Satanaj zëmërenë t'ënde që të gënjenjç ti Frymën' e-Shënjtëruarë, edhe të fsheç nga të-çëmuarët' e arësë? ⁴ Gjersa mbeteshe **e-pashiturë**, a nuk' ishte jotja? edhe si ushit, a nuk' ishte ndë pushtett t'ënt? ç'pate që vure ndë zëmëretë këtë punë? nukë gënjeve njerës, po Perëndinë. ⁵ Edhe Anania, dyke dëgjuarë këto fjalë, ra **përdhe** edhe dha shpirtinë, edhe u hyri frik' e-madhe gjith' atyreve që dëgjuanë këto. ⁶ Edhe më të-rinjte ungritnë, edhe e mbështuallnë, edh' e nxuarnë jashtë edhe e kallnë ndë dhet.

⁷ Edhe si shkuanë sindonja tri orë, hyri edhe gruaja e ati pa diturë seç ishte bërë. ⁸ Edhe Pjetri i upërgjeq asaj, Thuaj-më, ndë për kaqë e shittë arënë? Edhe ajo tha, Po, për kaqë. ⁹ Atëhere Pjetri i tha asaj, Përse lithtë fjalë të ngisni Frymën' e Zotit? ja ndë derët **janë** këmbët' e atyreve që kallnë ndë dhet burrinë t'ënt, edhe dotë nxjerrënë jashtë **edhe** ty. ¹⁰ Edhe për-një-here **ajo** ra përanë këmbëvet t'ati, edhe

dha shpirtinë; edhe djaloshëtë, kur hynë, e gjetnë të-vdekurë, edhe si e nxuarnë jashtë, e kallnë ndë dhet për anë burrit të saj. ¹¹ Edhe i hyri frik' e-madhe gjithë kishësë, edhe gjith' atyreve që dëgjonin këto.

¹² Edhe me anë të duarvet t'apostojvet bëneshinë shumë shënja e çudira ndë mest të llauzit; (edhe ishinë me një zëmërë të-gjithë ndë kamaret të Solomonit.

¹³ Edhe nga të-tjerët asndonjet s'kuxonte të bashkonej me ata; po llauzi i madhëronte ata. ¹⁴ Edhe shtoneshinë më shumë dyke besuarë mbë Zotinë, shumica burrash e grash;) ¹⁵ Kaqë sa nxirninë jashtë ndëpër rrugat të-sëmurëtë, edhe i vininë mbi shtresa e mbi shtrate, që kur të shkonte Pjetri pak së-paku hieja e ati të zinte ndonjë nga ata. ¹⁶ Edhe mblidhej ndë Jerusalem edhe shumica e qytetevet rrotullë, edhe bininë të-sëmurët' edhe ata që ngiteshinë prej frymërash të-pëgëra, të-cilëtë shëroneshinë që të-gjithë.

¹⁷ Atëhere ungrit kryepriifti edhe gjith' ata që ishinë bashkë me atë, të-cilët' ishinë prej sektës' së Sadduqenjet, edhe umbushnë me smir; ¹⁸ Edhe vunë duart' e tyre mbi apostojtë, edhe i vunë ndë burkt të gjindjesë. ¹⁹ Po një ëngjell i Zotit natënë hapi dyert' e burgut, edhe si i nxori jashtë, u tha ²⁰ Shkoni, edhe rrii e flisi-i ndë hieroret llauzit gjithë fjalët' e kësaj jete. ²¹ Edhe si dëgjuanë, hynë ndë hieroret mbë të-sbardhëlluerët, edhe mësoninë. Po kur erdhi kryepriifti edhe ata që ishinë bashkë me atë, thërritnë bashkë-ndënjën' edhe gjithë pleqësin' e të bijvet të Israilit, edhe dërguanë ndë burkt, që t'i binin' ata. ²² Po shërbëtorët, kur vanë, nuk' i gjetnë ata ndë burkt; edhe ukthyen' e u dhanë zë atyre, ²³ Dyke thënë, Se burgun' e gjetmë të-mbyllurë me çdo siguri, edhe ruajtësitë dyke ndënjurë jashtë përpara dyrvet; po kur hapmë, brënda nukë gjetmë asnjeri.

²⁴ Edhe kur dëgjuanë këto fjalë priifti edhe i-par' i hieroresë edhe kryepriiftëritë, vrisninë mëndjenë për ata, se si dotë bënë të këjo **punë**. ²⁵ Atëhere erdhi një njeri e u dha zë atyreve, dyke thënë, Se ata burra që vutë ndë burkt ja tek janë dyke ndënjurë ndë hieroret, e po mësonjënë llauzinë.

²⁶ Atëhere vate i-par' i **hieroresë** bashkë me shërbëtorët, e i prunë, **po** jo me shtrëngatë, sepse kishinë frikë nga llauzi semos i vrisninë me gurë. ²⁷ Edhe si i prunë, i nxuarnë përpara bashkë-ndënjësë; edhe kryepriifti i pyeti ata, ²⁸ Dyke thënë, Nuk' u porositmë juve shtrënguarë të mos mësoni mbë këtë emërë? edhe **ju** ja tek mbushëtë Jerusalmnë me mësimnë t'uaj, edhe doni të bini mbi ne gjakun' e këti njeriu.

²⁹ Atëhere Pjetri edhe apostojt' **e-tjerë** upërgjeqn' e thanë, Duhetë t'i bindemi Perëndisë më tepërë se njerëzet. ³⁰ Perëndia i atërvet t'anë ngjalli Jisunë, të-cilinë ju e vratë edhe e vartë mbi dru. ³¹ Këtë Perëndia e lartësoj me anë të së-djathtës' së ti, **edhe e bëri** të-parë edhe shpëtimtar, që t'i apë pendim Israilit, edhe ndjesë fajesh. ³² Edhe ne jemi dëshmitarët' e ati për këto fjalë, edhe Frym' e-Shënjtëruarë, të-cilënë Perëndia u'a dha atyreve që i binden' ati.

³³ Edhe ata kur dëgjuanë, kërcëllininë dhëmbëtë, edhe bëninë këshillë t'i vrasënë. ³⁴ Atëhere ungrit ndë bashkë-ndënjët një Farise, që quhej Gamaliil, mësonjës i nomit, edhe i-nderçim mbë gjithë llauzinë, edhe urdhëroj t'i nxjerrënë jashtë apostojtë për një copë herë, ³⁵ Edhe u tha atyre, O burra Israilitë, Vështroni mirë ç'u kini për të bërë këtyre njerësve. ³⁶ Sepse përpara këtyre ditve ungrit Thevdhau, dyke thënë për vetëhen' e ti se diç është, edhe i ungjitnë prapa sindonja katrë qint burra; ay uvra edhe gjithë sa i bindeshin' ati upërndanë; edhe ubënë për asgjë. ³⁷ Pas këti ungrit Judhë Galileasi, ndë ditt të të-shkruarit **të njerësve**, edhe hoqi pas vetiu mjaft llaus; edhe ay humbi, edhe gjithë sa i ubitnë ati upërndanë. ³⁸ Edhe tashi po u them juve, Largohi nga këta njerës, edhe lir-i-ni; sepse ndë është kjo këshillë a këjo punë prej njerëzish, dotë prishetë; ³⁹ Po ndë është nga

Perëndia, nukë muntni t'a prishni atë; **edhe vështroni** semos gjëndeni ndë luftë edhe me Perëndinë.

⁴⁰ Edhe ata i ubintn' ati; edhe si thërritnë apostojtë, i rrahnë e i porositnë të mos flasënë mb'emërit të Jisujt, edhe i lëshuanë. ⁴¹ Ata pra iknë dyke ugëzuarë nga faqaja e bashkë-ndënjesë, se ubënë të-vëjejturë të çpërnderonenë për emërin' e ati. ⁴² Edhe përdita ndë hieroret e ndëpër shtëpit nukë pushoninë dyke mësuarë e dyke dhënë zën' e-mirë për Jisu Krishtinë.

Krye 6

¹ Edhe nd'ato dit kur po shumoneshinë nxënësitë, ubë një murmuri prej Gërqishtarëvet kundrë Ebrenjet, se të-vat' e tyre nukë shikoneshinë ndë shërbesët të-përditshme **të ushqimevet**. ² Atëhere të dy-mbë-dhjetëtë thërritnë shumicën' e nxënësët, e thanë, Nuk' është' e-pëlqyerë mbë ne të lëmë fjalën' e Perëndisë, e të shërbejmë ndëpër truvezat. ³ Mendohi pra, o vëllezër, e sgjithni prej jush shtatë burra me dëshmim **të-mirë e të-mbushurë** me Frymë të-Shënjtëruarë e me urtësi, të-cilëtë t'i vëmë mbë këtë punë. ⁴ Po neve dotë qëndrojmë mbë të-falurit e mbë shër-besët të fjalësë.

⁵ Edhe **këjo** fjalë upëlqye përpara gjithë shumicësë; edhe sgjithnë Stefaninë, **që ishte** një burrë plot me besë e me Frymë të-Shënjtëruarë, edhe Filippin' e Prohorin' e Nikanorin' e Timonin' e Parmenanë, edhe Nikollënë që ishte i-kthyerë Antioheas; ⁶ të-cilët' i qëndruanë përpara apostojvet; edhe passi ufalnë, vunë duartë mbi ata. ⁷ Edhe fjal' e Perëndisë shtonej, edhe numuri i nxënësët shumonej fort ndë Jerusalam; edhe shumic' e-madhe nga priftëritë i dëgoninë besësë.

⁸ Edhe Stefanin plot me besë e me fuqi, bënte çudira e shënja të-mëdha ndë llaust. ⁹ Po ungritnë ca nga sinagogjia që thuhet' e Libertinëvet, edhe e Qyrineaset, edhe e Aleksandreaset, edhe nga ata **që ishinë** nga Qiliqia e nga Asia, e haheshinë me fjalë me Stefaninë; ¹⁰ Edhe s'muntninë të dilninë kundrë urtësisë edhe Frymësë, me të-cilë-në fliste. ¹¹ Atëhere vunë e gënjenë **ca** njerës të thonë, Se e dëgjuam' dyke folurë fjalë sharjeje kundrë Moisiut edhe Perëndisë. ¹² Edhe ngritnë mbë këmbë llauzin' e pleqt' e shkronjësitë, edhe dyke uhedhurë mbi atë e rrembyenë, edhe e prunë ndë bashkë-ndënjet. ¹³ Edhe nxuarnë përpara dëshmitarë gënjeshtarë, që thoshinë, Ky njeri nukë pushon së foluri fjalë sharjeje kundrë këti vëndi të-shënjtëruarë, edhe kundrë nomit. ¹⁴ Sepse e dëgjuam' atë dyke thënë, se Jisu Nazoreasi dotë prishnjë këtë vënt, edhe dotë ndërronjë zakonetë që na ka lënë Moisiu. ¹⁵ Edhe gjith' ata që rrininë ndë bashkë-ndënjet, kur shtynë sytë mb'atë, panë faqen' e ati posi faqe ëngjëlli.

Krye 7

¹ Atëhere kryeprihti tha, Vallë me të-vërtetë janë këto kështu?

² Edhe ay tha, O burra vëllezër edhe atër, pa dëgjoni; Perëndia i lavdisë i uduk atit t'ënë Avraamit, kur ishte ndë Mesopotami, para se të vinj' e të rrijë ndë Haran, ³ Edhe i tha, "Dil prej dheut t'ënt, edhe prej far' e fisit t'ënt, edhe eja ndë atë dhe që dotë të dëftenj ty." ⁴ Atëhere **ay** dolli nga dheu i Halldhenjvet, e vate ndënji ndë Harran. Edhe që andej, pas vdekjes' së t'et, e pruri të rrijë ndë këtë dhe, ndë të-cilët rrii ju tashi. ⁵ Edhe nuk' i dha ati trashëgim nd'atë **dhe** as një çap këmbë; po i uzotua se dot'j'a apë për kamje ati, edhe farës' s'ati pas ati, ndonëse s'kishte **edhe** fëmijë. ⁶ Perëndia foli kështu, "Se far' e ati dotë vejë e të rrijë për një kohë ndë dhe të-huaj, edhe dot'a bënëjën rop edhe dot'a mundonjëjë katrë qint vjet. ⁷ Edhe kombinë, tek i-cili dotë jenë robër dot'a gjykonj unë, tha Perëndia; edhe pastaj dotë dalënë edhe dotë më adhuronjëjë ndë këtë vënt." ⁸ Edhe i dha ati dhjatën'

e rrethpresjesë; edhe kështu i lindi Isaaku, edhe e rrethpreu mbë të-tettënë ditë; edhe Isaakut **i lindi** Jakovi, edhe Jakovit të dy-mbë-dhjetë krye-atëritë.

⁹ Edhe krye-atëritë, passi e kishinë cmir Josifnë, e shitnë nd'Egjiptë; po Perëndia ishte bashkë me atë, ¹⁰ Edhe e shpëtoj nga gjithë shtrëngimet' e ati, edhe i dha hir e dituri përpara Faraonit, mbretit t'Egjiptësë, i-cili e vu atë të-parë përmbi Egjiptënë edhe përmbi gjithë shtëpin' e ti.

¹¹ Edhe ubë një zi mbë gjithë dhen' e Egjiptësë edhe të Hanaanit, edhe një shtrëngim i-math; edhe atëritë t'anë nukë gjeninë ç'të haninë. ¹² Po Jakovi kur dëgjoj se kishinë grurë nd'Egjiptë, dërgoj të-parënë herë atëritë t'anë. ¹³ Edhe të-dytënë herë Josifi unjoh te të vëllezërit' e ti, edhe ubë e-çfaqurë te Faraoni far' e Josifit. ¹⁴ Edhe Josifi dërgoj e thërriti t'an' e ti Jakovinë, edhe gjithë njerëzin' e ti, shtatë-dhjet' e pesë shpirt. ¹⁵ Edhe sbriti Jakovi nd'Egjiptë, edhe vdiq **atje** ay edhe atëritë t'anë. ¹⁶ Edhe uprunë ndë Shihem edhe uvunë nd'atë varr që pat blerë Avraami me çëmim ergjëndi prej të bijvet t'Emmorit t'et të Shihemit.

¹⁷ Po kur uafërua koha e të zotuarit që i pat bërë be Perëndia Avraamit, ushtua llauzi edhe ushumua nd'Egjiptë; ¹⁸ Gjersa ungrit një tjetërë mbret, i-cili nuk' e njihte Josifnë. ¹⁹ Ky, dyke përdorurë dinakërirra kundrë kombit t'ënë, i mudoj atëritë t'anë, kaqë sa të hethnjënë foshnjat' e tyre, që të mos mbetenë të-gjallë.

²⁰ Ndë këtë kohë lindi Moisiu edhe kishte bukuri Perëndie; i-cili uushqye tre muaj ndë shtëpi të t'et. ²¹ Edhe kur uhoth, e mori atë e bija e Faraonit, edhe e rriti për bir të saj. ²² Edhe Moisiu umësua ndë gjithë diturit të Egjiptianëve, edhe ishte i-fortë ndë fjalë e ndë punëra.

²³ Edhe tek po ishte dyke mbushurë dyzet vjet, i erdhi ndë zëmëret të vej' e të shohë vëllezërit' e ti, të bijt' e Israilit. ²⁴ Edhe kur pa një që po i bënej keq, i doli për zot, edhe mor çpagim për atë që mundonej, dyke vrarë Egjiptianinë. ²⁵ Edhe pandehte, se të vëllezërit' e ti dotë kupëtoninë se Perëndia u ep atyre shpëtim me anë të dorës' s'ati; po ata nukë kupëtuanë. ²⁶ Edhe ditënë tjetërë uduk mb'ata tek po ziheshinë, edhe i nguti ndë paqtim, dyke thënë, O burra, ju jeni vëllezër; përse i bëni keq njeri tjetërit? ²⁷ Po ay që i bënte keq të-afërmit e shtyti, edhe tha, Cili të vuri të-parë edhe gjyka-tës mbi ne? ²⁸ Mos do ti të më vraç, sikundrë vrave dje **atë** Egjiptianinë? ²⁹ Atëhere Moisiu iku për këtë fjalë, edhe ndënj i-huaj ndë dhet Madhiam, ku i linternë dy bij.

³⁰ Edhe passi umbushnë dyzet vjet, i uduk ati ndë shkretëtirët të malit Sina një ëngjëll i Zotit ndë flakët të një zjarri ferre. ³¹ Edhe Moisiu kur pa, uçudit për **këtë** të-pamë; edhe tek afëronej që të vështronjë, erdhi zë prej Zotit tek ay, ³² "Unë **jam** Perëndia i atërvet të tu, Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia i Jakovit." Edhe Moisiu utrëmp, e s'kuxonte të vështronjë. ³³ Atëhere Zoti i tha, "Sgith sholëzën' e-këmbëvet të tua, sepse vëndi, përmbi të-cilinë ke ndënjurë, është i-shënjtëruar." ³⁴ "Pashë, pashë të-hequritë keq të llauzit t'im nd'Egjiptë, edhe dëgjova psherëtimën' e atyre, edhe sbrita që t'i shpëtonj; edhe ndashti eja, dotë të dërgonj ty nd'Egjiptë."

³⁵ Këtë Moisinë që e mohuanë, dyke thënë, Cili të vuri të-parë edhe gjykatës? këtë Perëndia e dërgoj të-parë edhe shpërblimtar me anë të dorës' s'ëngjëllit që i uduk ati ndë ferrët. ³⁶ Ky i nxori ata, passi bëri çudira e shënja ndë dhet t'Egjiptësë, edhe ndë Dett të-Kuq, edhe ndë shkretëtirët dyzet vjet. ³⁷ Ky është **ay** Moisiu që u tha të bijvet të Israilit, **se** "Zoti Perëndia juaj dot'u ngrerë juve prej vëllezërvet t'uaj **një** profit posi mua; ati t'i dëgjoni." ³⁸ Ky është ay që qe ndë përmbledhjet ndë shkretëtirët bashkë me ëngjëllinë që i fliste ati ndë malt Sina, edhe me atëritë t'anë, i-cili priti fjalë të-gjalla, për të dhënë neve. ³⁹ Atëritë t'anë nukë deshnë t'i dëgjonjë, po e hojnë tej, edhe me zëmërat' e tyre ukthyenë nd'Egjiptë, ⁴⁰ Dyke thënë Aaronit, "Bë-na perëndira, të-cilëtë të ecënjënë përpara nesh; sepse këti

Moisiut, që na nxori nga dheu i Egjyptësë, nukë dimë seç i gjau.”⁴¹ Edhe bënë një viç nd’ato dit, edhe i prunë kurban idhullit, edhe gëzoneshinë mbë punërat të duarvet të tyre.⁴² Përandaj Perëndia ukthye edhe i la t’adhuronjënë ushtërin’ e qiellit, sikundrë është shkruarë ndë vivlit të profitërvet, “Mos më prutë mua të-therura edhe kurbanë ndë shkretëtirët dyzet vjet, o shtëpi’ e Israilit?”⁴³ Po ngritë lart tendën’ e Mollohut, edhe yllin’ e perëndisë s’uaj Remfan, figuratë që bëtë që t’u faleni atyre; përandaj dot’u ngre e dot’u shpie më tej Vavillonësë.”

⁴⁴ Tend’ e dëshmimit ishte ndë atërit t’anë ndë shkretëtirët, sikundrë porositi ay që i fliste Moisiut t’a bënë atë pas shëmbëllesësë që kishte parë,⁴⁵ Të-cilënë edhe e muarnë atëritë t’anë me vetëhe, edhe bashkë me Jisun’ e **Naviut** e prunë ndë dhet të kombevet, të-cilët Perëndia i përzuri prej faqes’ s’atërvet t’anë, gjer ndë ditt të Dhavidhit;⁴⁶ I-cili gjeti hir përpara Perëndisë, edhe kërkoi të gjenjë të-ndënjurë për Perëndin’ e Jakovit.⁴⁷ Edhe Sollomoni i ndërtoj ati shtëpi.⁴⁸ Po i-Larti nukë rri ndër tempuj që bënenë me dorë, sikundrë thotë profiti,⁴⁹ “Qielli është froni im, edhe dheu ndënkëmbje e këmbëvet të mia; ç’farë shtëpie dotë ndërtoni për mua? thotë Zoti; a cili **është** vëndi i të prëjturit t’im?”⁵⁰ A nuk’ i ka bërë dora ime këto të-gjitha?”

⁵¹ O sverk-ashpërë edhe të-parrethprerë ndë zëmëret e ndë veshët, ju gjithënjë i rri kundrë Frymës’ së-Shënjtëruarë; sikundrë atëritë t’uaj, **kështu** edhe ju.

⁵² Cilinë nga profitëritë nukë ndoqnë atëritë t’uaj? po edhe i vran’ ata që dhanë zë që përpara për të-ardhurit’ e të-Drejtit, të-cilit ju ndashti ubëtë trathëtorë edhe vrasës;⁵³ **Ju** që muartë nomnë prej porosirash ëngjëjve, edhe nuk’ e ruajtë.

⁵⁴ Edhe **ata** kur dëgjonin këto, u priste ndë zëmërat të tyre, edhe kërcëllininë dhëmbët kundrë ati.⁵⁵ Po ay, që ishte plot me Frymë të-Shënjtëruarë, shtyri sytë ndë qiellit, e pa lavdin’ e Perëndisë, edhe Jisunë dyke ndënjurë prej së-djathtës’ së Perëndisë,⁵⁶ Edhe tha, Ja tek po shoh qiejtë të-hapurë, edhe të Birr’ e njeriut dyke ndënjurë prej së-djathtës’ së Perëndisë.⁵⁷ Atëhere **ata** bërtitnë me zë të-math, e zunë veshët’ e tyre, edhe me një zëmërë udruthnë mbi atë;⁵⁸ Edhe passi e nxuarnë jashtë qytetit, i shtininë me gurë. Edhe dëshmitarëtë lanë rrobat’ e tyre për anë këmbëvet të një djaloshi që quhej Savëll.⁵⁹ Edhe i shtininë Stefanit me gurë tek lutej e thoshte, O Zoti Jisu, prit frymënë t’ime.⁶⁰ Edhe si uunj mbë gjunjë, thërriti me zë të-math, O Zot, mos u’a zërë atyre këtë faj; edhe dyke thënë këtë flejti.

Krye 8

¹ Edhe Savlli e pëlqente vrasjen’ e ati. Edhe atë ditë ubë një ndjekje e-madhe kundrë kishësë që ishte ndë Jerusolim; Edhe të-gjithë upërndanë ndëpër vëndet të Judhesë e të Samarisë, përveç apostojet.

² Edhe **ca** burra besëtarë e ngritnë Stefaninë, edhe bënë vajë të-madhe mbi atë.

³ Edhe Savlli i bënte keq kishësë, dyke hyrë ndëpër shtëpirat, e dyke hequrë svarë burra e gra i hithe ndë burk.⁴ Ata pra që upërndanë shkuanë vënt mbë vënt, dyke ungjillëzuarë fjalënë.

⁵ Edhe Filippi sbriti ndë qytet të Samarisë, e u lëçiste atyre Krishtinë.⁶ Edhe gjindja me një zëmërë u vininë vëshnë atyre që thoshte Filippi, sepse dëgjonin’ e shihninë çuditë që bënte.⁷ Sepse prej shumë **vetash** që kishinë frymë të-pëgëra dilninë **këto** dyke thërriturë me zë të-math; edhe shumë ulogë e të-çalë ushëruanë.⁸ Edhe ubë gëzim i-math nd’atë qytet.

⁹ Edhe ishte që më përpara nd’atë qytet një njeri që quhej Simon, i-cili bënte magji edhe e nxirte mënj llauzin’ e Samarisë, dyke thënë për vetëhen’ e ti se është një **njeri** i-math;¹⁰ Të-cilit të-gjithë, i-math e i-vogëlë, i vininë vëshnë, e thoshinë, Ky është fuqi’ e-madhe e Perëndisë.¹¹ Edhe i vininë vëshnë, sepse mjaft kohë i kish nxjerrë mënj me magjitë.¹² Po kur i besuanë Filippit që epte zën’ e-mirë për

punët' e mbretëris' së Perëndisë, edhe për emërin' e Jisu Krishtit, pagëzonzeshinë burra e gra. ¹³ Po edhe Simoni vetë besoj, edhe si upagëzua, rrinte bashkë me Filipinë, edhe dyke parë se bënëshinë çudira të-mëdha manitej.

¹⁴ Edhe apostojtë që ishinë ndë Jerusolim, kur dëgjuanë se Samaria e priti fjalën' e Perëndi-së, dërguanë tek ata Pjetrin' edhe Joaninë; ¹⁵ Të-ciletë sbritnë e ufalnë për ata, që të marrënë Frymë të-Shënjtëuarë. ¹⁶ (Sepse edhe s'kishte sbriturë as mbë ndonjë nga ata, po vetëm' ishinë pagëzuarë mb'emërit të Zotit Jisu.)

¹⁷ Atëhere vininë duartë mbi ata edhe merrninë Frymë të-Shënjtëuarë.

¹⁸ Edhe Simoni kur pa, se me të-vënët' e duarvet t'apostojvet epetë Frym' e-Shënjtëuarë, u pruri atyre aspra, ¹⁹ Dyke thënë, Ep-më-ni edhe mua këtë pushtet, që mbi cilinëdo që të vë duartë, të marrë Frymë të-Shënjtëuarë. ²⁰ Po Pjetri i tha ati, Ergjëndi yt humptë bashkë me ty, sepse pandehve, se dhurëtia e Perëndisë fitonetë me aspra. ²¹ Ti s'ke pjesë as shortë ndë këtë fjalë; sepse zëmëra jote s'është' e-drejtë përpara Perëndisë. ²² Pendohu pra nga këjo e-liga jote, edhe lut-i-u Perëndisë, mbase të ndjenetë këjo çpikje e zëmëresë s'ate; ²³ Sepse po të shoh se je ndër vërer hidhërie edhe ndë lidhje paudhërie. ²⁴ Atëhere Simoni upërgjeq e tha, Lutuni ju Zotit për mua, që të mos vinjë mbi mua asndonjë nga ato që thatë.

²⁵ Ata pra, passi dhanë dëshmim edhe folnë fjalën' e Zotit, ukthyenë ndë Jerusolim, edhe dhanë zën' e-mirë ndëpër shumë katunde të Samaritëvet.

²⁶ Edhe një ëngjëll i Zotit i foli Filippit dyke thënë, Ngreu e shko nga an' e mesditësë, mb'udhët që sbret prej Jerusalimit ndë Gazë; (këjo është shkretëtirë).

²⁷ Edhe ay ungrit e vate.

Edhe ja një njeri Ethiop, i-dredhurë, i-fortë zotëni i Kandhakësë, mbretëreshës' s'Ethiopëvet, i-cili ishte mbi gjithë thesarët t'asaj; ky kishte ardhurë që të faletë ndë Jerusolim; ²⁸ Edhe mbë të-kthyerë, dyke ndënjurë mbë qeret të ti, po këndonte profitin' Isai. ²⁹ Edhe Fryma i tha Filippit, Afërohu e i ungrit kësaj qereje. ³⁰ Edhe Filippi vate me vrap afërë, e dëgjoj atë dyke kënduarë profitin' Isai, edhe tha, A kupëton vallë ato që këndon? ³¹ Edhe ay tha, E qysh munt **të kupëtonj**, ndë mos më dëfteftë njeri? Edhe i ulut Filippit të hipënjë e të rrijë bashkë me atë. ³² Edhe vëndi i shkronjësë që po këndonte ishte ky, "Upru posi berr për të therurë, edhe posi qëng pa zë përpara ati që e qeth, kështu nukë hap gojën' e ti. ³³ Ndë të-unjurit t'ati ungrit gjyqi i ati; edhe brezin' e ati kush dot'a dëftenjë? sepse ngrihetë prej dheut jeta e ati." ³⁴ Edhe i-dredhuri upërgjeq e i tha Filippit, Të lutem, për cilinë profiti thotë këtë? për vetëhen' e ti, apo për ndonjë tjetërë? ³⁵ Atëhere Filippi hapi gojën' e ti, edhe dyke zënë nga këjo shkronjë i dha ati zën' e-mirë për Jisunë.

³⁶ Edhe tek po bënëinë udhë, erthnë mbë një ujë; edhe i-dredhuri thotë, Ja ujë; ç'farë gjëje më ndalon të pagëzohem? (Edhe Filippi i tha, Ndë beson me gjithë zëmërë, munt **të pagëzohesh**. ³⁷ Edhe **ay** upërgjeq e tha, Besonj se Jisu Krishti është' i Bir' i Perëndisë). ³⁸ Edhe urdhëroj të qëndronjë qereja; edhe sbritnë të dy ndë ujët, Filippi edhe i-dredhuri; edhe e pagëzoi. ³⁹ Edhe kur duallnë nga ujëtë, Frym' e Zotit rrëmbeu Filipinë, edhe i-dredhuri s'e pa më, po shkante udhës' së ti dyke ugëzuarë. ⁴⁰ Edhe Filippi ugjënt nd'Azotë, edhe mbë të-shkuarë epte zën' e-mirë ndëpër gjithë qytetet, gjersa erdhi ndë Qesari.

Krye 9

¹ Edhe Savlli, edhe po dyke çfryturë të-frikësuarë e vrasje kundër nxënësët të Zotit, erdhi te kryepriifti, ² Edhe lypi prej ati kartëra për sinagogjitë ndë Dhamaskë, që ndë gjettë ca prej **kësaj** udhe, burra e gra, t'i bjerë lidhurë ndë Jerusolim. ³ Edhe dyke vaturë tek afëronej ndë Dhamaskë, papandehuraj vetëtitit rreth ati një dritë prej qiellit; ⁴ Edhe **ay** si ra përdhe dëgjoj një zë dyke thën' ati, Saull, Saull, përse

më ndjek? ⁵ Edhe **ay** tha, Cili je **ti**, o Zot? Edhe Zoti tha, Unë jam Jisuj që ndjek ti; keq **është** për ty t' u bjesh me shkëlme gjëmbavet. ⁶ Edhe ay dyke udridhur' e dyke uhabiturë tha, Zot, ç' do **ti** të bënj unë? Edhe Zoti **i tha**, Ngreu e hyrë ndë qytett, edhe dotë të flitetë ç' duhetë të bënjç. ⁷ Edhe burratë që bëninë udhë bashkë me atë rrininë të-habiturë, sepse zën' e dëgjoninë, po asndonjë nukë shihninë. ⁸ Edhe Savlli ungrit nga dheu, edhe ndonëse kishte sytë të-hapurë, nukë shihte asndonjë; edhe dyke hequrë atë prej dore, e prunë ndë Damaskë. ⁹ Edhe tri ditë nukë shihte; edhe as hëngri, as piu.

¹⁰ Edhe ishte një nxënës ndë Dhamaskë që quhej Anani, edhe Zoti i tha nd'ëndërrë, Anani, Edhe ay tha, Ja unë **këtu jam**, o Zot. ¹¹ Edhe Zoti i tha, Ngreu e shko nd' **atë** udhët që quhetë e-Drejtë, edhe kërkë ndë shtëpit të Judhësë një Tarsiot që quhetë Savëll; sepse ja tek po faletë, ¹² Edhe ka parë nd'ëndërrë një njeri që quhet' Anani, se hyri edhe vuri dorënë mbi atë, që t'i vinjënë sytë përsëri. ¹³ Atëhere Anania upërgjeq, Kam dëgjuarë prej shumë **vetash** për këtë njeri, sa të-këqia u bëri shënjtorëvet t'ënt ndë Jerusalem; ¹⁴ Edhe këtu ka pushtet nga kryepriftëritë të lithnjë gjith' ata që thërrësënë mb'emërinë t'ënt. ¹⁵ Po Zoti i tha, Ecë, se ky më është një enë e-sgjedhurë për të mbajturë emërinë t'im përpara kombevet, e mbretërvet, edhe të bijvet të Israilit. ¹⁶ Sepse unë dot'i dëftenj ati sa duhetë të pësonjë për emërinë t'im.

¹⁷ Edhe Anania vate e hyri ndë shtëpit; edhe si vuri duartë mbi atë, tha, Saull vëlla, Zoti më ka dërguarë, **ay** Jisuj që t'uduk udhësë, kur ishnje dyke ardhurë, që të hapenë sytë përsëri, edhe të mbushesh me Frymë të-Shënjtëruarë. ¹⁸ Edhe për-një-here ranë nga syt' e ati posi folla **peshku**, edhe i erthnë sytë për-një-here; ¹⁹ edhe ungrit e upagëzua. Edhe si hëngri, mori fuqi.

Edhe (Savlli) ndënj ca ditë bashkë me nxënë-sitë që ishinë ndë Dhamaskë. ²⁰ Edhe për-një-here lëçiste Krishtinë ndëpër sinagogjit, se ky është i Bir' i Perëndisë. ²¹ Edhe gjith' ata që dëgjoninë maniteshin' e thoshninë, Nuk' është ky ay që prishi ndë Jerusalem ata që thërrisininë mbë këtë emërë, edhe këtu për këtë **qëllim** kishte ardhurë, që t'i shpjerë ata lidhurë te kryepriftëritë? ²² Po Savlli më tepërë forconej, edhe i trumbullonte Judhenjtë që rrininë ndë Dhamaskë, dyke dëftyerë, se ky është Krishti.

²³ Edhe si shkuanë mjaft ditë, Judhenjtë bënë këshillë t'a vrasënë. ²⁴ Po kundrëkëshilla e atyreve i ra ndër veshë Savllit, edhe ruaninë dyertë dit' e natë, që t'a vrisninë. ²⁵ Atëhere nxënësit' e muarnë natënë, edhe e sbritnë nga muri, dyke varurë atë ndë një çportë. ²⁶ Edhe Savlli, si erdhi ndë Jerusalem, përpiqeshe të bashkonetë me nxënësitë; po të-gjithë kishinë frikë prej ati, sepse nukë besoninë se është nxënës. ²⁷ Po Varnava e mori, edhe e pruri tek apostojtë edhe u dëfteu atyre qysh pa Zonë mb'udhët, edhe se i foli ati, edhe qysh ndë Dhamaskë fliste me kuxim mb'emëritë të Jisujt. ²⁸ Edhe ishte dyke hyr' e dyke dalë bashkë me ata ndë Jerusalem, edhe dyke folurë me kuxim mb'emëritë të Zotit Jisu. ²⁹ Edhe fliste e hahej me Greqishtarëtë; po ata kërkoninë t'a vrisninë. ³⁰ Edhe vëllezëritë kur e muarnë vesh, e sbritnë ndë Qesari, edhe e dërguanë ndë Tarsë.

³¹ Kishëtë pra ndëpër gjithë Judhënë e Galilenë e Samarinë kishinë paqtim, edhe ishinë dyke undërtuar' e dyke ecurë ndë frikët të Perëndisë, edhe me anë të ngushëllimit të Frymës' së-Shënjtëruarë shumoneshinë.

³² Edhe Pjetri, dyke shkuarë ndëpër gjithë **ata vënde**, sbriti edhe te shënjtorëtë që ishinë ndë Lydhë. ³³ Edhe atje gjeti një njeri që e quaninë Ene, i-cili ishte ulok që dergjej tetë vjet ndë shtratt. ³⁴ Edhe Pjetri i tha, Ene, Jisu Krishti të shëron; ngreu edhe shtro shtratinë t'ënt. Edhe **ay** për-një-here ungrit. ³⁵ Edhe e pan' atë gjith' ata që rrininë ndë Lydhë e ndë Saron, edhe ukthyenë mbë Zotinë.

³⁶ Edhe ndë Joppë ishte një nxënëse që quhej Tavitha, që e-kthyerë do me thënë, Zarkadhe; ajo ishte plot me punëra të-mira e me eleimosina që bënte. ³⁷ Edhe nd'ato dit goditi të sëmuretë, edhe të vdesë; edhe si e lanë e vunë ndë një dhomë të-sipërme. ³⁸ Edhe Lydha passi ishte afërë Joppësë, nxënësitë, kur dëgjuanë se Pjetri është nd'atë, dërguanë dy burra tek ay, dyke lutur' ati të mos përtonjë të vinjë gjer tek ata. ³⁹ Edhe Pjetri ungrit e vate bashkë me ata; të-cilinë posa erdhi e hipnë ndë dhomët të-sipërme; edhe i duallnë përpara gjithë **grat'** e-veja dyke qarë, e dyke dëftyerë këmishë e roba, të-cilatë i bënte Zarkadhja, kur ishte bashkë me ato. ⁴⁰ Po Pjetri, passi i nxori të-gjithë jashtë, uunj mbë gjunjë edhe ufal; edhe si ukthye nga trupi, tha, Tavitha, ngreu. E ajo hapi syt' e saj, edhe kur pa Pjetrinë, ungrit e ndënj. ⁴¹ Edhe ay i dha dorënë, edhe e ngriti; edhe passi thërriti shënjtorët' e të-vejatë, e nxori përpara të-gjallë. ⁴² Edhe **këjo** umuar vesh ndëpër gjithë Joppënë; edhe shumë **vet**a besuanë mbë Zotinë. ⁴³ Edhe **Pjetri** mbeti mjaft dit ndë Joppë, përënë një farë Simoni lëkurëregjës.

Krye 10

¹ Edhe ishte një njeri ndë Qesari që quhej Kornil, krye-qindës prej tufës' **s'ushtëtorëvet** që quhej Italiane; ² **Ky ishte** besëtar edhe kishte frikë nga Perëndia bashkë me gjithë shtëpin' e tij, edhe i bënte shumë eleimosina llauzit, edhe i lutej Perëndisë gjithënjë. ³ Ky sindonja mbë të-nënttënë orë të ditësë pa ndë të-faniturë kthjellëtë një ëngjëll të Perëndisë, se hyri tek ay, e i tha, Kornil. ⁴ Edhe ay kur shtyri sytë mb'atë, e mori frika, edhe tha, C'është, o Zot? Edhe ay i tha ati, Të-falurat' e tua edhe eleimosinat' e tua hipnë për kujtim përpara Perëndisë. ⁵ Edhe ndashti dërgo njerës ndë Joppë, edhe thirrë Simoninë që përmbiemëronetë Pjetër; ⁶ Ky ka rënë ndë një farë Simoni lëkurëregjës, i-cili e ka shtëpinë përënë detit; (ky dotë të flasë ç'duhetë të bënjç.) ⁷ Edhe si iku ëngjëlli që ishte dyke folurë (Kornilit), thërriti dy **vet**a nga shërbëtorët' e ti, edhe një ushtëtuar besëtar nga ata që rrininë përherë përënë' ati; ⁸ Edhe si u dëfteu atyre të-gjitha, i dërgoj ndë Joppë.

⁹ Edhe mbë të-nesërmenë, tek ishinë ata dyke bërë udhë e po afëroneshinë ndë qytett, Pjetri hipi ndë dhomët të faletë, afëro mbë të-gjashtëtën' orë. ¹⁰ Edhe e mori uria, edhe donte të hajë; po tek po bënëni gati, i erdhi një të-habiturë; ¹¹ Edhe sheh qiellinë të-hapurë, edhe një enë dyke sbiturë mbi atë posi një pëlhur' e-madhe, lidhurë nga të katrë çipetë, edhe dyke rënë mbi dhet; ¹² Brënda nd'atë ishinë gjithë shtëzatë e dheut katrë-këmbëse, e bishatë, e shtërpinjëtë, e shpest' e qiellit. ¹³ Edhe erdhi një zë tek ay, Ngreu, Pjetër, ther e ha. ¹⁴ Po Pjetri tha, Qoftë lark, o Zot! sepse kurrë s'kam ngrënë gjë të-ndyr' a të-pëgërë. ¹⁵ Po përsëri për së-dyti erdhi një zë tek ay, Ato që ka qëruarë Perëndia, ti mos i quaj të-ndyra. ¹⁶ Edhe këjo ubë tri herë; edhe përsëri ena umuar lart ndë qiell.

¹⁷ Edhe Pjetri tek po ishte dyke vrarë mëndjenë me vetëhen' e ti, vallë ç'dotë jetë këta të-parë që pa, ja burratë, që ishinë dërguarë nga Kornili, passi pyetnë për shtëpin' e Simonit, arritnë ndë portët; ¹⁸ Edhe dyke thirrurë pyetninë, ndë ka rënë këtu Simoni që përmbiquhetë Pjetër.

¹⁹ Edhe Pjetri **atje** tek ishte dyke menduarë për të parëtë **që pa**, Fryma i tha, Ja tek po të kërkonjë tre burra; ²⁰ Ngreu pra e sbit, e shko bashkë me ata, pa mos pasurë ndonjë farë dyshimi; sepse un' i kam dërguar' ata. ²¹ Edhe Pjetri, passi sbiti tek **ata** njerëzitë që ishinë dërguarë tek ay nga Kornili, tha, Ja, unë jam ay që kërkon; për ç'punë keni ardhurë? ²² Edhe ata thanë, Kornili, krye-qindësi, që është njeri i-drejtë edhe ka frikë nga Perëndia, edhe për të-cilinë ep dëshmim të-mirë gjithë kombi i Judhenjet, uurdhërua nga Perëndia me anë një ëngjëlli të-shënjtëruarë, që të të thërresë ndë shtëpit të ti, edhe të dëgjonjë fjalë prej teje. ²³ **Ay** pra i thërriti ata brënda, e i gostiti. Edhe mbë të-nesërmenë doli Pjetri

bashkë me ata, edhe ca nga vëllezëritë që **ishinë** nga Joppa erdhë bashkë me atë; ²⁴ Edhe mbë të-nesërmenë hynë ndë Qesari; edhe Kornili ishte dyke pritur' ata, edhe kishte mbledhurë far' e fisn' e ti edhe miqt' **e-ti** të-ngushtë.

²⁵ Edhe Pjetri posa hyri brënda, Kornili i dolli përpara, e i ra ndër këmbë, edhe i ufal. ²⁶ Po Pjetri e ngriti, dyke thënë, Ngreu; **sepse** edhe unë jam njeri. ²⁷ Edhe dyke folurë bashkë me atë hyri brënda, edhe gjen mbledhurë shumë **veta**.

²⁸ Edhe u tha atyre, Ju e dini se s'është' e-ndjerë për një njeri Judhe të shoqëronjë a të vejë mbë njeri prej tjetërë kombi; po Perëndia më dëfteu të mos them as për ndonjë njeri se është i-ndyrë a i-pëgërë. ²⁹ Përandaj, posa uthërricë, edhe erdha pa bërë fjalë; pyes pra, për ç'fjalë dërguat' e më prutë? ³⁰ Edhe Kornili tha, Katrë dit më parë gjer mbë këtë orë ishnja dyke agjruarë, edhe mbë të-nënttënë orë po faleshe ndë shtëpit t'ime; edhe ja një njeri me rroba të-ndritura tek qëndroj përpara meje, ³¹ Edhe thotë, Kornil, udëgjua të-faluritë t'ënt, edhe eleimosinat' e tua upërmëntnë përpara Perëndisë. ³² Dërgo pra ndë Joppë, e thirrë Simoninë, që përmbluqetë Pjetër; ky ka rënë ndë shtëpit të Simon lëkurëregjisit për anë detit; ay kur të vinjë dotë të flasë. ³³ Për-një-here pra dërgova te ti; edhe ti bërë mirë që erdhe. Ndashti pra neve të-gjithë jemi përpara Perëndisë, që të dëgjojmë gjithë ç'janë urdhëruarë te ti prej Perëndisë.

³⁴ Atëhere Pjetri hapi gojën' e tha. Me të-vërtetë po e marr vesh, se Perëndia s'mban anë njeriu; ³⁵ po mbë çdo komp ay që ka frikë prej ati edhe punon drejtëri, është i-priturë tek ay. ³⁶ Fjalënë që u dërgoj bijvet të Israilit, dyke ungjillëzuarë paqtim me anë të Jisu Krishtit; (ky është Zoti i të-gjithëve); ³⁷ **Këtë** fjalë ju e dini, që upërhap ndëpër gjithë Judhënë, dyke zënë nga Galilea, pas pagëzimit që lëçiti Joani; ³⁸ Qysh leu Perëndia Jisunë nga Nazareti me Frymë të-Shënjtëruarë e me fuqi, i-cili shkoj vënt mbë vënt dyke bërë mirë e dyke shëruarë gjith'ata që mundoneshinë prej djallit; sepse Perëndia ishte bash-kë me atë. ³⁹ Edhe neve jemi dëshmitarë për gjith' ato që bëri edhe ndë dhet të Judhenjet edhe ndë Jerusalem; të-cilin' e vranë dyke varurë mbë dru; ⁴⁰ Këtë Perëndia e ngjalli të-tretënë ditë, edhe e bëri atë të duketë, ⁴¹ Jo mbë gjithë llausnë, po mbë dëshmitarët' e-sgjedhurë që përpara prej Perëndisë, **do-me-thënë** mbë neve që hëngrëm' e pimë bashkë me atë, pasi u ngjall prej së-vdekurish; ⁴² Edhe na porositi neve të lëçisëmë te Ilauzi, edhe të dëshmojmë, se ay është ay që qe urdhëruarë prej Perëndisë gjykatës i të-gjallëve e të-vdekurve. ⁴³ Për këtë dëshmonjënë gjithë profitëritë, se me anë të emërit t'ati dotë marrë ndjesë fajesh kushdo që i beson ati.

⁴⁴ Pjetri tek po ishte dyke folur këto fjalë, ra Frym' e-Shënjtëruarë mbi gjith' ata që dëgjoninë fjalënë. ⁴⁵ Edhe umanitnë ata besëtarëtë që ishinë prej rrethpresjesë, sa kishinë ardhurë bashkë me Pjetrinë, se edhe mbë kombet' uderthka Frym' e-Shënjtëruarë. ⁴⁶ Sepse dëgjonin' ata dyke folurë gjuhëra, e dyke madhëruarë Perëndinë. ⁴⁷ Atëhere Pjetri upërgjeq, Mos munt të ndalonjë ujëtë ndonjë që të mos pagëzonenë këta, të-cilëtë muarnë Frymën' e-Shënjtëruarë, sikundrë edhe neve? ⁴⁸ Edhe i urdhëroj ata të pagëzonenë mb'emërit të Zotit. Atëhere i ulutnë të mbetetë pak dit **tek ata**.

Krye 11

¹ Edhe apostojt' e vëllezëritë që ishinë ndë Judhet dëgjuanë, se edhe kombetë pritnë fjalën' e Perëndisë. ² Edhe kur hipi Pjetri ndë Jerusalem, haheshinë me atë ata që **ishinë** prej rrethpresjesë, ³ Dyke thënë, Se hyre ndë njerës të-parethprerë, e hëngre bashkë me ata.

⁴ Po Pjetri zuri e u dëfteu atyre sa **ubënë** një nga një, ⁵ dyke thënë, Unë ishnjam dyke falurë ndë qytett të Joppësë; edhe pashë një pamje ndë të-habiturë, një enë që sbriste posi **një** pëlhur' e-madhe, e-cila **lidhurë** nga të katrë çipetë lëshonej

poshtë nga qielli, edhe erdhi gjer tek unë; ⁶ Ndë të-cilët, kur hodha sytë, vura re e pashë shtëzët' e dheut katër-këmbëse, e bishatë, e shtërpinjët, e shpest' e qiellit ⁷ Edhe dëgjova një zë që më thoshte, Ngreu Pjetër, ther e ha. ⁸ Po **unë** thashë, Qoftë lark, o Zot! se gjë e-ndyrë a e-pëgërë, askurrë s'ka hyrë ndë gojët t'ime. ⁹ Po zëri m' upërgjeq për-së-dyti nga qielli, Ato që i ka qëruarë Perëndia, ti mos i thuaj të-ndyra. ¹⁰ Edhe këjo ubë tri herë; edhe përsëri uhoqnë të gjithë ndë qiellit. ¹¹ Edhe na ndë gjithatë orë tek arritnë tre burra ndë shtëpit që ishnjam, të-dërguarë nga Qesaria tek unë. ¹² Edhe Fryma më tha të vete bashkë me ata pa mos pasurë asndonjë dyshim; edhe erthnë bashkë me mua edhe këta të gjashtë vëllezër, edhe hymë ndër shtëpit t'ati njeriu. ¹³ Edhe **ay** na dëfteu, qysh pa ëngjëllinë ndë shtë-pit të ti, se ndënji e i tha ati, Dërgo ndë Joppë, e thirrë Simoninë që përmbiquhetë Pjetër; ¹⁴ Edhe ay dotë të flasë ty fjalë, me anë të të-cilavet dotë shpëtonjç ti edhe gjithë shtëpia jote. ¹⁵ Edhe unë posa zura të flas, Frym' e-Shënjtëruarë ra mbi ata, sikundrë edhe mbë ne herën' e-parë. ¹⁶ Atëhere më ra ndër mëntt fjal' e Zotit që thoshte, Joani pagëzoi me ujë, po ju dotë pagëzohi me Frymë të-Shënjtëruarë. ¹⁷ Ndë u dha pra Perëndia atyre dhurëtinë sinjnjë, sikundrë edhe neve, sepse i besuanë Zotit Jisu Krisht, unë cili ishnjam që të munt të ndalonj Perëndinë?

¹⁸ Edhe **ata** si dëgjuanë këto fjalë, uqetuanë edhe lavduroninë Perëndinë, dyke thënë, Edhe kombevet pra u paskërka dhënë Perëndia pendimnë për jetë.

¹⁹ Ata pra që upërdanë nga ndjekja që ubë për Stefaninë vatnë gjer ndë Finikë e ndë Qyprë e ndë Antiohi, edhe asnjeriu s'ja lëcisninë fjalënë, veç vetëmë Judhenjet. ²⁰ Edhe ca nga ata ishinë njerës Qyprianë e Qyrineas, të-cilëtë, si hynë ndë Antiohi, u flisninë Greqishtarëvet, dyke dhënë zën' e-mirë për Zotinë Jisu.

²¹ Edhe dor' e Zotit ishte bashkë me ata; edhe shumë numër **njerëzish** besuanë, e ukthyenë mbë Zotinë. ²² Atëhere fjala për ata udëgjua ndë veshët të kishësë që ishte ndë Jerusolim; edhe dërguanë Varnavënë të shkonjë gjer ndë Antiohi. ²³ Ay si erdhi, edhe pa hirin' e Perëndisë, ugëzua edhe nguste të-gjithë të qëndroninë me dëshërim zëmëre mbë Zotinë; ²⁴ Sepse ishte njeri i-mirë edhe plot me Frymë të-Shënjtëruarë e me besë. Edhe ushtua mjaft gjindje mbë Zotinë.

²⁵ Atëhere Varnava dolli ndë Tarsë, për të kërkuarë Savllinë; edhe si e gjeti, e pru nd'Antiohi. ²⁶ Edhe një mot të-tërë mblidheshinë ndë kishët, edhe mësuane mjaft gjindje; edhe nxënë-sitë ndë Antiohi për të-parënë herë u quajtnë të-Krishterë.

²⁷ Edhe nd'ato dit sbritrnë nga Jerusolimi profitër ndë Antiohi. ²⁸ Edhe ungrit një nga ata që quhej Agaf, e shënoj me anë të Frymësë, se dotë bënej një zi e-madhe mbë gjithë dhenë, e-cila edhe ubë ndë kohët të Qesar Kllavdiut. ²⁹ Përandaj nxënësitë vendosnë që gjithë-sicili nga ata, sipas gjëndjes' së ti, t'u dërgojnë ndihmë vëlle-zëret që rrininë ndë Judhë; ³⁰ të-cilënë **gjë** edhe e bënë, dyke dërguarë **atë** pleqvet me dorë të Varnavës' e të Savllit.

Krye 12

¹ Nd'atë kohë mbreti Irodh vuri duartë t'u bënëj keq cave prej kishësë. ² Edhe vrau me thikë Jakovinë të vëllan' e Joanit. ³ Edhe kur pa se këjo është e-pëlqyerë te Judhenjtë, vuri ndër mëntt të zërë edhe Pjetrinë; (edhe **atëhere** ishinë ditt' e pabrumjevet;); ⁴ Të-cilinë edhe e zuri edh' e vuri ndë burk, edhe e dha ndër duar të katrë palëve ushtëtorësh prej katrë vetash sicila, që t'a ruanjënë, sepse pas pashkësë donte t'a nxirte përpara llauzit. ⁵ Pjetri pra po ruhej ndë burkt; po prej kishësë bënej pa pusxim të-falurë për atë.

⁶ Edhe kur dot' a nxirte atë Irodhi përpara, atë natë Pjetri lidhurë me dy vargje ishte dyke fjeturë ndër mest dy ushtëtorëve, edhe ruajtësitë ruaninë burgunë përpara derësë. ⁷ Edhe ja një ëngjëll i Zotit tek erdhi papandehuraj, edhe dritë ndriti nd'atë vënt; edhe si i ra Pjetrit ndë brinjët, e sgoj, dyke thënë, Ngreu çpejt. Edhe

i ranë vargjetë nga duartë. ⁸ Edhe ëngjëlli i tha, Ngjishu, edhe mbath këpucët' e tua; edhe **ay** bëri ashtu. Edhe i thotë, Vish rrobënë t'ënde, edhe eja pas meje. ⁹ Edhe **ay** si dolli i vinte pas, edhe nukë dinte, se ishte e-vërtetë këjo që bënej prej ëngjëllit, po pandehte se sheh të-faniturë. ¹⁰ Edhe si shkuanë të-parënë edhe të-dytënë ruajtje, erdhë ndë portët të-hekurtë, që shpie ndë qytett, e-cila uhap atyreve prej vetiu; edhe si duallnë, shkuanë ndëpër një rrugë; edhe për-një-here ëngjëlli unda nga ay. ¹¹ Edhe Pjetri, si erdhi ndër vetëhe, tha, Ndashti e di me të-vërtetë, se Zoti dërgoj ëngjëllin' e ti, edhe më shpëtoj nga dor' e Irodhit, edhe nga gjithë shpresa e llauzit të Judhenjvet. ¹² Edhe passi umëndua me vetëhe, erdhi ndë shtëpit të Marisë s'ëmës' së Joanit që përmbiquhej Mark, **atje** tek ishinë mjaft **veta** mbledhurë edhe po faleshinë. ¹³ Edhe kur trokëlliti (Pjetri) ndë portët të avllisë, erdhi një shërbëtore që quhej Rodhë, për të dëgjuarë; ¹⁴ edhe **ajo** kur njohu zën' e Pjetrit, nga gëzimi nukë hapi portënë, po shkoj me vrap brënda edhe dha zë, se Pjetri po rri përpara portësë. ¹⁵ Edhe ata i than' asaj, Shkallove; po ajo qëndronte **dyke thënë**, se kështu është. Edha ata thoshninë, se Eshtë ëngjëll' i ati. ¹⁶ Po Pjetri po qëndronte dyke trokëlliturë, edhe si i hapnë, e pan' atë edhe umanitnë. ¹⁷ Po ay u bëri atyre shënjë me dorë të mos bënëjë zë, e u tregoj atyre, qysh e nxori Zoti nga burgu; edhe tha, Epni zë Jakovit edhe vëllezëret për këto. Edhe dolli e vate mbë **një** tjetërë vënt.

¹⁸ Edhe si ubë ditë, ubë shumë trazyrë ndër ushtëtorët, vallë ç'ubë Pjetri. ¹⁹ Edhe Irodhi kur e kërkoi e s'e gjeti, passi pyeti ruajtësitë, urdhëroj të vritenë, edhe sbriti nga Judhea ndë Qesari, e shkonte kohënë **atje**.

²⁰ Edhe Irodhi ishte fort zëmëruarë me Tyrasit' e me Sidhonasitë; po ata erdhë me një zëmërë tek ay, edhe si i mbushnë mëndjenë Vllastit, kamarierit të mbretit, lypninë **të bënëinë** paqtim; sepse vëndi i atyreve ushqenej prej vendit të mbretit. ²¹ Edhe një ditë të-ndarë Irodhi veshi rrobë mbretërie, edhe ndënji ndë front, e u ligjëronte atyre. ²² Edhe llauzi me zë të-math thoshte, **Ky zë është** zë Perëndie, e jo njeriu. ²³ Edhe për-një-here një ëngjëll i Zotit e goditi atë; sepse nuk' i dha lavdinë Perëndisë; edhe si e hëngrrë krimbatë dha shpirtinë.

²⁴ Edhe fjal' e Perëndisë shtonej e shumonej. ²⁵ Edhe Varnava e Savlli, passi mbaruanë shërbesënë **që patnë**, ukthyenë nga Jerusalimi, passi muarnë me vetëhe Joaninë që upërmbiquajt Mark.

Krye 13

¹ Edhe ndë kishët që ishte ndë Antiohi ishinë ca profitër e mësonjës, Varnava edhe Simeoni që quhej Nigjer, edhe Lluqi Qyrineasi, edhe Manaini që ishte rriturë bashkë me Irodhinë katrurdhëratësinë, edhe Savlli. ² Edhe tek ishinë ata dyke i shërbyerë Zotit edhe dyke agjëruarë, Frym' e-Shënjtëruarë tha, Nda-më-ni veç Varnavën' edhe Savllinë për atë punë që i kam thërritur' ata. ³ Atëhere si agjëruan' e ufalënë, edhe vunë duartë mbi ata, i lëshuanë.

⁴ Këta pra passi udërguanë nga Frym' e-Shënjtëruarë, sbritnë ndë Selefqi, edhe prej andej lundruanë për ndë Qyprë. ⁵ Edhe kur erthnë ndë Salaminë, lëcitrnë fjalën' e Perëndisë ndëpër sinagogjit të Judhenjet; edhe kishin' edhe Joaninë shërbëtuar. ⁶ Edhe si kapëtuan' ujdhezënë gjer ndë Pafë, gjetnë një farë magjistari profit të-rrem Judhe, që e kishte emërinë Var-jisu, ⁷ i-cili ishte bashkë me guvernatorinë Sergji Pavlinë, **që ishte** një burr' i-mënçim. Qy thërriti Varnavën' edhe Savllinë, edhe kërkoi të dëgjonjë fjalën' e Perëndisë. ⁸ Po Elyme magjistari, (sepse kështu kthenet' emër' i ati,) rrinte kundrë atyre, e kërkonte t'a kthenjë guvernatorinë nga besa.

⁹ Po Savlli, (që quhej edhe Pavël), umbush me Frymë të-Shënjtëruarë, e shtyri sytë mbi atë, ¹⁰ Edhe tha, O **ti që je** plot me çdo kobim e me çdo farë intrige, i bir' i

diallit, e armiku i çdo drejtërie, nukë dotë pushonç së prishuri udhët' e-drejta të Zotit? ¹¹ Edhe ndashti ja dor' e Zotit tek është mbi ty; edhe dotë mbetesh i-verbërë, e nukë dotë shohç djellinë gjer mbë një kohë. Edhe për-një-here ra mbi atë një **si** mjegullë e errësirë, edhe dyke ardhurë rrotullë kërkonte **njerës** që t'a hiqninë prej dore. ¹² Atëhere kur pa guvernatori seç ubë, besoj, e çuditëj për mësimn' e Zotit.

¹³ Edhe Pavli edhe ata që ishinë rreth ati, passi ungritnë me anije nga Pafa, erthnë ndë Pergët të Pamfylisë; edhe Joani unda nga ata, edhe ukthye ndë Jerusolim.

¹⁴ Edhe ata passi shkuanë nga Perga, erthnë ndë Antiohi të Pisidhisë, edhe si hynë ndë sinagogjit ditën' e-shëtunë, ndenjën. ¹⁵ Edhe pas të-kënduarit të nomit edhe të profitërvet, të-parët' e sinagogjisë dërguanë tek ata, dyke thënë, O burra vëllezër, ndë kini ndonjë fjalë për të mësuarë llauzit, thoni.

¹⁶ Atëhere Pavli si ungrit e bëri shënjë me dorë, tha, O burra Israilitë, edhe ju që i kini frikë Perëndisë, pa dëgjoni. ¹⁷ Perëndia i këti llauzi, i Israilit, sgjodhi atëritë t'anë, edhe ngriti llauzinë që rrinte i-huaj ndë dhet t'Egjiptësë, edhe me krahe të-lartë i nxori ata prej asaj. ¹⁸ Edhe gjer mbë dyzet vjet duroj mëndyrat' e atyre ndë shkretëtirët; ¹⁹ Edhe passi prishi shtatë kombe ndë dhet të Hanaanit, u ndau atyre me shortë dhen' e atyreve. ²⁰ Edhe pastaj për sindonja katër qint e pesë-dhjetë vjet u dha atyre gjykatës gjer mbë kohët të profitit Samuil. ²¹ Edhe pastaj lypnë mbret, edhe Perëndia u dha atyre Saullinë të birr' e Qisit, një burrë prej farës' së Veniaminit, për dyzet vjet. ²² Edhe si e hoqi atë, u ngriti atyre Dhavidhinë për mbret, për të-cilinë edhe dëshmoj, dyke thënë, "Gjeta Dhavidhinë të **birr'** e Jesseut, njeri pas zëmëresë s'ime, i-cili dotë bënë dashurimet' e mi." ²³ Prej farës' së këti Perëndia pas të-zotuarit **të ti**, ngriti mbë Israilinë shpëtimtar Jisunë, ²⁴ Passi Joani lëçiti, para se të vinte ay, pagëzim pendimi mbë gjithë llauzin' e Israilit; ²⁵ Edhe Joani kur po mbaronte udhën' e ti, thoshte, Cili pandehni se jam unë? unë nukë jam **ay**; po ja tek vjen pas meje ay, të-cilit **unë** nukë jam i-zoti t'i s'gith këpucën' e këmbëvet.

²⁶ O burra vëllezër, të bijt' e farës' s'Avraamit, edhe sa janë ndër ju që i kanë frikë Perëndisë, mbë ju udërgua fjal' e këti shpëtimi. ²⁷ Sepse ata që rrinë ndë Jerusolim, edhe të-parët' e tyre, passi nuk' e njohën këtë, as fjalët' e profitërvet që këndonë çdo të-shëtunë, i mbushnë **ato**, kur e gjyquanë; ²⁸ Edhe ndonëse s'gjetnë asndonjë faj për vdekje, lypnë prej Pillatit që të vritetë. ²⁹ Edhe passi mbaruanë gjith'ato që ishinë shkruarë për atë, e sbritnë prej drurit, edhe e vunë ndë var. ³⁰ Po Perëndia e ngjalli prej së-vdekurish. ³¹ Edhe ay uduk për shumë dit mb'ata që hipnë bashkë me atë prej Galilesë ndë Jerusolim, të-cilëtë janë dëshmitarë të ati te llauzi.

³² Edhe neve po uapëmë juve zën' e-mirë për të-zotuarëtë që qe bërë mb'atëritë, ³³ Se këtë Perëndia e mbushi mbë ne bijt' e atyre, edhe ngjallurë Jisunë; sikundër edhe ndë Psallmët të-dytë është shkruarë "Ti je Biri im; unë sot të kam pjellë."

³⁴ Edhe se e ngjalli prej së-vdekurish, që të mos kthenetë më ndë prishje, ka thënë kështu, "Se dot' u ap juve të-zotuarat' e Dhavidhit që **uzotuashë** me besë."

³⁵ Përandaj edhe ndë një tjetërë Psallmë thotë, "Se nukë dotë lesh Shënjtinë t'ënt të shohë prishje." ³⁶ Sepse Dhavidhi, passi ndë brest të ti i shërbeu andës' së Perëndisë, fjeti, edhe uvu tek atërit' e ti, edhe pa prishje; ³⁷ Po Ay, të-cilin' e ngjalli Perëndia, nukë pa prishje.

³⁸ Letë jetë pra e-diturë mbë ju, o burra vëllezër, se me anë të këti lëçitetë mbë ju ndjesë fajesh, ³⁹ edhe prej gjith' atyre **punërave** që nukë munttë të drejtërohi me anë të nomit të Moisiut, me anë të këti kushdo që beson drejtëronetë. ⁴⁰ Shikoni pra semos vinjë mbë ju ajo që është thënë prej profitërvet; ⁴¹ "Shikoni ju që nukë më zini për gjë, edhe çudituni, edhe humbisni; sepse unë **dotë** punonj një punë ndër ditt t'uaj, një punë që nukë dot'a besoni, ndë u'a tregoftë ndonjë juve."

⁴² Edhe kur po dilninë (nga sinagogjia e Judhenjvet), u luteshinë (kombetë) t'u flitenë **edhe** atyreve këto fjalë të-shëtunënë që vjen. ⁴³ Edhe si upërnda sinagogjia, shumë prej Judhenjet edhe prej besëtarëvet të-kthyerë vanë prapa Pavlit edhe Varnavësë; të-cilëtë dyke folur' atyreve u mbushninë mëndjenë të mbetenë ndë hirt të Perëndisë. ⁴⁴ Edhe të-shëtunë tjetërë umloth po-thua gjithë qyteti, që të dëgjoninë fjalën' e Perëndisë. ⁴⁵ Po Judhenjtë, kur panë gjindjenë, umbushnë me çmir, edhe flisninë kundrë të-thënuravet prej Pavlit, dyke folurë kundrë e dyke sharë. ⁴⁶ Atëhere Pavli edhe Varnavë folnë me kuxim edhe thanë, Mbë ju ishte nevojë më parë të flitej fjal' e Perëndisë; po passi e hithni poshtë, edhe nuk' e gjykoni vetëhenë t'uaj të-vëjturë për jetën' e-përjetëshme, ja tek po kthenemi ndër kombet; ⁴⁷ Sepse kështu na ka porositurë Zoti, **dyke thënë**, "Të kam vënë për dritë të kombevet, që të jesh ti për shpëtim gjer ndë anë të dheut."

⁴⁸ Edhe kombetë, kur dëgjuanë, gëzonesthinë, edhe lavduroninë fjalën' e Zotit; edhe sa i ishin' urdhëruarë për jetën' e-përjetëshme besuanë. ⁴⁹ Edhe fjal' e Zotit përhapej ndëpër gjith' atë vënt. ⁵⁰ Po Judhenjtë shtyninë gratë që ishinë të-nderçura e me të-sjella të-mira, **si** edhe të-parët' e qytetit, edhe ngritnë ndjekje kundrë Pavlit edhe Varnavësë, edhe i nxuarnë nga sinorët' e tyre. ⁵¹ Po ata shkuntë pluhurin' e këmbëvet të tyre kundrë atyreve edhe erthnë ndë Ikoni. ⁵² Edhe nxënësitë mbusheshinë me gëzim me Frymë të-Shënjtëruarë.

Krye 14

¹ Edhe ndë Ikoni hynë bashkë ndë sinagogjit të Judhenjvet, edhe folnë kështu, sa besuanë një shumic' e-madhe prej Judhenjvet e prej Grekërvet. ² Po ata Judhenjtë që nukë bindeshinë ndesnë edhe prishnë shpirtërat' e kombevet kundrë vëllezërvet. ³ Mjaft kohë pra ndëjnë **atje**, dyke folurë me kuxim për Zotinë, i-cili dëshmonte për fjalën' e hirit të ti, edhe epte të bënenë shënja e çudira me anë të duarvet t'atyre. ⁴ Edhe shumica e qytetit unda **mbë dy**; e ca ishinë me Judenjtë, e ca me apostojtë. ⁵ Edhe kur udruthnë kombet' e Judhenjtë bashkë me të-parët' e tyre, që t'i shanjën' e t'i vrasënë me gurë, ⁶ **Ata** e muarnë vesh, edhe iknë ndë qytetet të Lykaonisë, Lystrë e Dervë, edhe ndë fshatërat rrotullë; ⁷ Edhe atje lëcisninë Ungjillinë.

⁸ Edhe ndë Lystrë rrinte një njeri i-dobëtë nga këmbëtë, sepse ishte i-çalë që nga barku i s'ëmësë, i-cili kurrë s'kishte ecurë. ⁹ Ky dëgjonte Pavlinë dyke folurë; i-cili, si shtyri sytë mb'atë edhe pa se kishte besë për të shpëtuarë, ¹⁰ Tha me zë të-math, Ngreu më këmbë **edhe rri** drejt. Edhe **ay** këcente edhe ecënte. ¹¹ Edhe gjindja kur panë seç bëri Pavli, ngritnë zën' e tyre, dyke thënë Lykaonisht, Perënditë ushëmbëllyenë mbë njerës e sbritnë ndër ne. ¹² Edhe quaninë Varnavënë Enjë, edhe Pavlinë Mërkur; sepse ky ishte i-pari që fliste. ¹³ Atëhere prifti i Enjëtit që ishte përpara qytetit t'atyre pruri dema e kurora përpara dyrvet, edhe bashkë me gjindjenë donte të bënjë kurban. ¹⁴ Po apostojtë Varnavë edhe Pavël kur dëgjuanë, çuarnë rrobat' e tyre, e uhothnë ndë mest të gjindjesë, dyke thërriturë, ¹⁵ E dyke thënë, O burra, përse bëni këto? edhe neve jemi njerës që pësojmë si edhe ju, edhe u lëcisëmë juve të ktheneni nga këto të-kota mbë Perëndin' e-gjallë, që bëri qjellin' edhe dhenë edhe gjithë ç'**janë** nd'ata; ¹⁶ I-cili ndë brezat që shkuanë la gjithë kombetë të ecënjënë nd'udhët të tyre; ¹⁷ Ndonëse nuk' e la vetëhen' e ti pa dëshmim, dyke bërë mirë, e dyke dhënë neve nga qielli shira e kohëra pemësjellëse, e dyke mbushurë zëmëratë t'ona me ushqim e me gëzim. ¹⁸ Edhe dyke thënë këto, mezi ndaluanë gjindjenë që të mos u bënjënë atyre kurban.

¹⁹ Edhe mbi këto e sipër erthnë **ca** Judhenj nga Antiohia e nga Ikonia, edhe i mbushnë mëndjenë gjindjesë, e rrahnë me gurë Pavlinë, edhe e hoqnë **svarë**

jashtë qytetit, sepse pandehën se vdiq. ²⁰ Po kur e qarkuanë nxënësitë, ungrit e hyri në qytet, edhe mbë të-nesërmet doli bashkë me Varnavënë në Dervë.

²¹ Edhe passi lëcitrinë ungjillinë nd'atë qytet, edhe bënë mjaft nxënës, ukthyenë në Lystrë e në Ikoni, e në Antiohi, ²² Dyke forcuarë shpirtërat' e nxënëset, e dyke shtyturë ata të qëndronjënë në besët, edhe **dyke thënë atyre** se me shumë shtrëngime duhetë të hyjmë në mbretërit të Perëndisë. ²³ Edhe si u urdhëruanë atyre me të vënë duartë pleq mbë çdo kishë, edhe ufalnë me agjërime, i lanë te Zoti që i kishinë besuarë. ²⁴ Edhe si shkuanë ndëpër Pisidhi, erdhë në Pamfyli; ²⁵ edhe si folnë fjalënë në Pergë, zbritnë në Attali; ²⁶ Edhe s'andejmi lundruanë për në Antiohi, atje ku ishinë dhënë në hirt të Perëndisë për punënë që mbaruanë.

²⁷ Edhe si erthnë, mbllohnë kishënë, edhe udëfytën' atyre sa bëri Perëndia me anë t'atyreve, edhe se hapi ndër kombet derën' e besësë. ²⁸ Edhe ndënjnë atje shumë kohë bashkë me nxënësitë.

Krye 15

¹ Edhe ca **veta** që sbritrnë nga Judhea mësoninë vëllezëritë, Se në mos urrethpreshi pas zakonit të Moisiut, s'munt të shpëtoni. ² Po passi Pavli edhe Varnava u ndënjnë kundrë edhe uhëngrrë me fjalë jo pak me ata, vendosnë që Pavli edhe Varnava edhe ca të-tjerë nga ata të hipënjënë te apostojt' edhe te pleqtë në Jerusolim për këtë çështje. ³ Ata pra si upërcuallnë nga kisha, shkoninë ndëpër Finikë e ndëpër Samari, dyke treguarë të kthyerët' e kombevet; edhe u bininë gëzim të-math gjithë vëllezëret. ⁴ Edhe kur erthnë në Jerusolim, upritnë prej kishës' e prej apostojvet e prej pleqvet, edhe dhanë zë për **gjithë** sa bëri Perëndia me anë t'atyreve. ⁵ Po ungritnë ca nga sekt' e Farisenjvet që kishinë besuarë, e thoshinë, Se duhetë të rrethpresëm' ata e t'i porositmë të ruanjënë nomn' e Moisiut.

⁶ Edhe umblohnë apostojt' e pleqtë të shikonjënë për këtë punë.

⁷ Edhe passi ubë shumë të-ngrënë me fjalë, ungrit Pjetri, e u tha atyre, O burra vëllezër, e dini se që në ditë të-lashta Perëndia ndër mest t'ënë sgjodhi, që me anë të gojës' s'ime të dëgjonjënë kombetë fjalën' e ungjillit edhe të besonjënë.

⁸ Edhe zëmërë-njohësi Perëndi dha dëshmim mbë ata, dyke dhënë atyre Frymën' e-Shënjtëruarë sikundrë edhe neve. ⁹ Edhe nukë bëri ndonjë të-çqarë ndër mest t'ënë e t'atyreve, dyke qëruarë zëmërat' e atyre me anë të besësë. ¹⁰ Tashi pra përse ngisni Perëndinë, **e kërkoni** të vini mbë qafët të nxënëset një sgjedhë, të-cilënë as atëritë t'anë as neve nukë muntmë t'a mbajmë? ¹¹ Po me anë të hirit të Zotit Jisu (Krishtit) besojmë se dotë shpëtojmë, sikundrë edhe ata.

¹² Edhe gjithë shumica pushoj, edhe dëgjoninë Varnavën' edhe Pavlinë që dëfteninë sa shënja e çudira bëri Perëndia me anë t'atyre ndër mest të kombevet.

¹³ Edhe si pushuanë ata, upërgjeq Jakovi, dyke thënë; O burra vëllezër, pa më dëgjon; ¹⁴ Simeoni dëfteu, me ç'farë mënyrë Perëndia të-parënë herë shtyri sytë mbi kombetë, që të marrë prej atyre **një** llaus për emërin' e ti. ¹⁵ Edhe me këtë janë një fjalët' e profitërvet, sikundrë është shkruarë, ¹⁶ "Pas këtyre dotë kthehem e dotë ndërtonj përsëri tendën' e Dhavidhit që është rrëzuarë; edhe të-rrëzuarat' e asaj dot'i ndërtonj përsëri, edhe dot'a ngre atë më këmbë; ¹⁷ Që të kërkonjënë Zotinë njerëzit' e-tjerë, edhe gjithë kombetë, mbë të-cilëtë thërritetë emëri im, thotë Zoti që bën këto të-gjitha." ¹⁸ Që prej jete janë të-njohura te Perëndia gjithë punët' e tia. ¹⁹ Përandaj un' e shoh të udhësë të mos i nga-sëm' ata që kthenenë nga kombetë te Perëndia; ²⁰ Po t'u shkruajm' atyre të heqënë dorë nga gjakurësirat' e idhujvet, edhe nga kurvëria, edhe nga gjëj' e-mbyturë, edhe nga gjaku. ²¹ Sepse Moisiu që prej brezash të-lashtë ka mbë çdo qytet ata që e lëcisen' atë ndëpër sinagogjit, ku këndonetë çdo të-shëtunë.

²² Atëhere uduk **pun'** e-pëlqyerë të apostojt' edhe të pleqtë bashkë me gjithë kishënë të sgjedhënë burra nga mezi i tyre, edhe t'i dërgonjënë ndë Antiohi bashkë me Pavlin' e me Varnavënë; **edhe sgjodhë** Judhënë që përmbiquhej Varsava, edhe Sillënë, njerës të-parë ndër vëllezërit. ²³ Edhe u shkruanë me anë të dorës' s'atyre këto:

Apostojt' edhe pleqt' edhe vëllezëritë **mbë ju** vëllezëritë prej kombeve **që gjëndeni** ndëpër Antiohinë e ndëpër Syrin' e ndëpër Qiliqinë, gëzuashi. ²⁴ Passi dëgjuamë se erthnë ca **veta** prej nesh, e u trumbullanë juve me fjalë, edhe prishnë shpirtëratë t'uaj, dyke thënë të rrethpriti e të ruani nomnë, të-cilëtë neve nuk' i porosimtë **për këtë**; ²⁵ Na uduk e-pëlqyerë neve që jemi mbledhurë bashkë më një zëmërë, të sgjedhëmë njerës, edhe t'i dërgojmë te ju bashkë me të-dashuritë t'anë Varnavë edhe Pavël, ²⁶ Njerës që kanë dhënë jetët' e tyre për emërin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht. ²⁷ Dërguamë pra Judhën' edhe Sillënë, që t'u thonë edhe ata me gojë po ato. ²⁸ Sepse i uduk e-pëlqyerë Frymës' së-Shënjtërua-rë edhe neve, të mos u vëmë juve **tjetërë** barrë përveç këtyre që janë të-nevojshime, ²⁹ Të hiqni dorë nga kurbanët' e idhujvet, edhe nga gjaku, edhe nga gjëj' e-mbyturë, edhe nga kurvëria; nga këto ndë ruajçi vetëhenë t'uaj, dotë bëni mirë. Qofshi me shëndet.

³⁰ Këta pra si ulëshuanë, erthnë nd' Antiohi; edhe mblotnë shumicënë, e u dhan' atyre ndër duar kartënë. ³¹ Edhe ata, si e kënduanë, ugëzuanë për ngushëllimnë **që u dha**. ³² Edhe Judha edhe Silla, që edhe ata ishinë profitër, ngushëlluanë vëllezëritë me shumë fjalë, e i forcuënë. ³³ Edhe si ndënjnë **atje ca** kohë, udërguanë prapë me paqtim nga vëllezëritë tek apostojtë. ³⁴ Po Sillësë i uduk mirë të mbetetë aty. ³⁵ Edhe Pavli e Varnava rrininë ndë Antiohi, dyke mësuar' e dyke lëçiturë fjalën' e Zotit, bashkë me shumë të-tjerë.

³⁶ Edhe pas ca ditsh Pavli i tha Varnavësë, Letë kthenemi tashi të shohëmë vëllezëritë t'anë mbë çdo qytet që dhamë zën' e-mirë për Zotinë, **vallë** si janë. ³⁷ Edhe Varnava donte të marrë me vetëhe Joaninë që quhej Mark; ³⁸ Po Pavli s'e gjente për mirë të marrë me vetëhe atë, që qe ndarë prej atyreve nga Pamfylia, edhe nuk' erdhi me ata ndë punët. ³⁹ Gjau pra një qartë, kaqë sa undanë ata njëri prej tjetërit; edhe Varnava mori me vetëhe Markunë, edhe lundroj për ndë Qyprë.

⁴⁰ Po Pavli sgjodhi Sillënë, edhe dolli, si udha prej vëllezërvet ndë hirt të Perëndisë. ⁴¹ Edhe shkuanë ndëpër Syri e ndëpër Qiliqi, dyke forcuarë kishëtë.

Krye 16

¹ Edhe arriu ndë Dervë e ndë Lystrë; edhe ja tek ishte atje një nxënës që quhej Timothe, i bir' i një gruaje Judheonë besëtare, edhe i një ati grek; ² Për të-cilinë epej dëshmim i-mirë prej vëllezërvet që ishinë ndë Lystrë e ndë Ikonë. ³ Këtë e desh i Pavli që të dalë bashkë me atë; edhe si e mori, e rrethpneu, për punë të Judhenjet që ishinë ndër ata vënde, sepse të-gjithë e dininë t'an' e ati se ishte Grek. ⁴ Edhe dyke shkuarë ndëpër qytetet, u lininë atyre **porosi** të ruanjënë dhogmatë që ishinë urdhëruarë nga apostojt' e nga pleqtë që ishinë ndë Jerusalem. ⁵ Kishëtë pra forconëshinë ndë besët, edhe përdita shtoneshinë nga numëri.

⁶ Edhe passi shkuanë ndëpër Frygjit e ndëpër dhet të Gallatisë, sepse undaluanë nga Frym' e-Shënjtëruarë të lëçisninë fjalënë nd' Asi, erthnë ndë Mysi, ⁷ Edhe kërkoninë të venë ndë Vithini, po Fryma nuk' i la. ⁸ Edhe si shkuanë ndëpër Mysit, sbrintë ndë Troadhë. ⁹ Edhe Pavlit i uduk natënë një të-faniturë, se një njeri Maqedhonas rrinte **përpara** dyke lutur' e dyke thënë ati, Shko ndë Maqedhoni, e ndih-na. ¹⁰ Edhe posa pa të-fanituritë, për-një-here kërkuanë të vemi ndë Maqedhoni, sepse e muarmë me mënt se Zoti po na thërrret t'u apëmë atyre zën' e-mirë.

¹¹ Si lundruamë pra nga Troadha, e muarmë udhënë drejt për ndë Samothrakë, edhe mbë të-nesërmet për ndë Neapolë, ¹² Edhe s'andejmi për ndë Filippë, që është qytet i-parë i asaj ane së Maqedhonisë, një e-përngulurë **Romanësh**; edhe ndënjmë ca dit ndë këtë qytet.

¹³ Edhe ditën' e-shëtunë duallmë jashtë qytetit për anë një lumi, ku ishte zakon të bënë të-falurë, edhe ndënjmë, edhe flisnimë me gratë që ishinë mbledhurë **atje**. ¹⁴ Edhe një grua që quhej Lydhi, nga qytet' i Thyatirësë, e-cila shiste porfirëra, e druate Perëndinë, po dëgjonte; sepse Zoti i hapi zëmërenë t' u mbanjë vesh fjalëve që fliste Pavli. ¹⁵ Edhe si upagëzua **ajo** edhe shtëpi' e asaj, **na** lutej, dyke thënë, Ndë më paçi gjykuarë se jam besëtare mbë Zotinë, hyni ndë shtëpit t'ime, edhe rrini; edhe na shtrëngoij shumë.

¹⁶ Edhe kur po vinimë neve për të falurë, upoq me ne një shërbëtore që kishte frymë Pythoni, e-cila u epte shumë fitim zotërinjvet të saj dyke rrëfyerë **njerësvet** fatinë. ¹⁷ Ajo vate prapa Pavlit e nesh, edhe bërtiste, dyke thënë, Këta njerës janë shërbëtorë të Perëndis' së-lartë, të-cilëtë na dëftënjën' udhën' e shpëtimit. ¹⁸ Edhe këtë e bënte shumë dit me radhë. Edhe Pavli si urëndua, ukthye e i tha frymësë, Të urdhëronj mb'emërit të Jisu Krishtit të dalç prej asaj. Edhe doli që atë orë.

¹⁹ Edhe zotërinj' e asaj, kur panë, se u hu-mbi shpresa e fitimit të tyre, zunë Pavlin' edhe Sillënë e i hoqnë ndë trekt te të-parëtë; ²⁰ Edhe si i prunë ata përpara të-mëdhenjvet, thanë, Këta njerës, dyke qenë Judhenj, trumbullonjë qyteti-në t'ënë; ²¹ Edhe mësonjë zakonë që s'është' e udhësë t'i presëmë ne; as t'i bëjmë, sepse jemi Romanë. ²² Edhe gjindja për së-bashkëti usulnë mbi ata, edhe të-mëdhenjtë u grisinë rrobatë, e urdhëruanë t'i rrahënë me shkopinj. ²³ Edhe si i bënë me shumë plagë, i vunë ndë burk, edhe porositnë ruajtësin' e burgut t'i ruanjë me siguri; ²⁴ I-cili si mori të-këllillë porosi, i vuri ndë burk të-përbrëndshëm, e u shtrëngoij këmbëtë ndë drut.

²⁵ Edhe ndë mest të natësë Pavli edhe Silla faleshin' e këndoninë lavdurime mbë Perëndinë; edhe të-lidhuritë u mbaninë vesh atyre. ²⁶ Edhe papandehuraj ubë një tërmet i-math, kaqë sa utuntnë themelet' e burgut; edhe për-një-here uhapnë dyertë, edhe të-gjithëve usgjithnë hekuratë. ²⁷ Edhe ruajtësi i burgut kur usgjua, edhe pa dyert' e burgut të-hapura, nxori thikënë, e donte të vriste vetëhen' e ti, sepse pandehte se kishinë ikurë të-lidhuritë. ²⁸ Po Pavli thërriti me zë të-math, dyke thënë, Mos i bëj ndonjë të-keqe vetëhesë s'ate; sepse të-gjithë jemi këtu.

²⁹ Atëhere ay lypi dritë, e këceu brënda, edhe dyke dridhurë u ra ndër këmbë Pavlit edhe Sillësë; ³⁰ Edhe si i nxori ata jashtë, tha, Zotërinj, ç'duhetë të bënj unë, që të shpëtonj? ³¹ Edhe ata i thanë, Beso-i Zotit Jisu Krisht, edhe dotë shpëtonç ti edhe shtëpia jote. ³² Edhe i folnë fjalën' e Zotit ati edhe gjith' atyreve që ishinë ndë shtëpit t'ati. ³³ Edhe ay i mori me vetëhe që nd'atë orë të natësë, e u lau plagëtë; edhe për-një-here upagëzua ay edhe gjithë të-titë; ³⁴ Edhe si i hipi sipërë ndë shtëpit të ti, u vuri përpara truvezë, edhe ugëzua me gjithë shtëpinë, sepse i besoj Zotit.

³⁵ Edhe si ugdhi, të-mëdhenjtë dërguanë shkopmbanjësitë, dyke thënë, Lësho ata njerës. ³⁶ Edhe ruajtësi i burgut i dha zë Pavlit për këto fjalë, Se të-mëdhenjtë kanë dërguarë që të lëshohi; tashi pra dilni, e shkoni ndë paqtim. ³⁷ Po Pavli u tha atyre, Passi na rrahnë ndër sy të botësë pa gjykuarë, **neve** që jemi njerës Romanë, e **na** vunë ndë burk, edhe tashi na nxjerrënë fshehurazë? ³⁸ Edhe shkopmbanjësitë u dhanë zë të-mëdhenjvet për këto fjalë; edhe **ata** ufrikësuanë, kur dëgjuanë se janë romanë; ³⁹ Edhe erthnë e u ulutnë atyre, edhe si i nxuarnë, u luteshinë të dalënë nga qyteti. ⁴⁰ Edhe **ata** si duallnë nga burgu, hynë **ndë shtëpit** të Lydhisë; edhe kur panë vëllezëritë, i ngushëlluan' e iknë.

Krye 17

¹ Edhe si bënë udhë ndëpër Amfipolë e ndëpër Apolloni, erthnë ndë Thessallonikë, ku ishte sinagogjia e Judhenjet. ² Edhe Pavli sipas zakonit **të ti** hyri tek ata, edhe tri të-shëtuna me radhë fliste me ata prej shkronjavet, ³ Dyke sgjidhur e dyke dëftyerë, se Krishti duhej të pësonte e të ngjallej prej së-vdekurish, edhe se ky është Krishti Jisuj, që po u lëcis unë juve. ⁴ Edhe cave nga ata umbush mëndja, edhe ubashkuanë me Pavlin' e me Sillënë, **si** edhe nga ata Grekëritë që ndruaninë nga Perëndia një shumic' e-madhe, edhe nga grat' e-para jo të-paka.

⁵ Po ata Judhenj, të-cilëvet s'u mbushej mëndja, ucmiruanë, edhe muarnë me vetëhe ca njerës të-këqinj nga ata **të rrugavet** të tregut, edhe mblotnë gjindje, edhe përzjeninë qytetinë; edhe usulnë ndë shtëpit të Jasonit, edhe kërkonin' ata, që t'i bininë te llauzi. ⁶ Po passi s'i gjetnë, hoqnë svarë Jasonin edhe ca vëllezër te të parët' e qytetit, dyke bërtiturë, se këta që ngritnë mbë këmbë botënë, kanë ardhurë edhe këtu, ⁷ Të-cilëtë Jasoni i priti ndë shtëpit; edhe të-gjithë këta punonjë në kundrë urdhëratavet të Qesarit, dyke thënë, Se është një tjetër mbret, Jisuj. ⁸ Edhe përzjenë gjindjenë edhe të-parët' e qytetit që dëgjoninë këto **fjalë**. ⁹ Edhe si usiguruanë prej Jasonit edhe prej të-tjerëvet, i lëshuanë.

¹⁰ Edhe vëllezëritë për-një-here natënë dërguanë jashtë Pavlin' edhe Sillënë ndë Verje; të-cilëtë kur erthnë **atje**, vanë ndë sinagogjit të Judhenjet. ¹¹ Po këta ishinë më të-fisçim se ata të Thessallonikësë, sepse pritnë fjalënë me gjithë zëmërë, dyke vëzhguarë përdita shkronjatë, ndë janë kështu këto **punëra**. ¹² Shumë **veta** pra nga ata besuanë, si edhe nga grat' e-nderçime të Grekërvet, edhe nga burratë jo të-pakë. ¹³ Po kur muarnë vesh Judhenjtë nga Thessallonika, se edhe ndë Verje prej Pavlit ulëcit fjal' e Perëndisë, erthnë edhe atje edhe trumbulluanë gjindjenë. ¹⁴ Edhe atëhere për-një-here vëllezëritë Pavlinë e dërguanë jashtë që të vejë gjer ndë dett; po Silla edhe Timotheu mbetnë atje. ¹⁵ Edhe ata që i hiqninë udhënë Pavlit e shpunë gjer nd'Athinë; edhe si muarnë porosi për Sillën' e për Timothënë, që të vinjë tek ay sa mundetë më çpejt, shkuanë.

¹⁶ Edhe Pavli tek ishte dyke priturë ata nd'Athinë, i përvëlonte brënda ndë shpirtt, kur shikonte qytetnë plot me idhuj. ¹⁷ Fliste pra ndë sinagogjit me Judhenjtë edhe me ata që ndruaninë prej Zotit, edhe ndë trekt çdo ditë me ata që goditte **të piqej**. ¹⁸ Edhe ca fillosofë nga Epikurianët' e nga Stoikëtë bininë ndë fjalë me atë; edhe ca thoshninë, Vallë ç'do të thotë ky llomatar? edhe të-tjerë thoshinë, Duketë, se është zëdhënës i perëndirave të-huaja; sepse u lëçiste atyre Jisunë, edhe të-ngjalluritë. ¹⁹ Edhe ata e zunë, edhe e shpunë nd'Areopagt, dyke thënë, A munt të marrëm vesh, ç'është ky mësim i-ri që flitetë prej teje? ²⁰ Sepse **ti na** bje ca gjërëra të-çudiçime ndë veshët t'anë. Duamë pra të marrëm vesh, ç'do të jenë këto. ²¹ Sepse gjith' Athinasit' edhe të-huajtë që rrinin' atje nukë kishinë nge për ndonjë tjetërë gjë, veç të thonë e të dëgjonjë ndonjë fjalë më të-re.

²² Atëhere Pavli qëndroj ndë mest të Areopagut, e tha, O burra Athinas, mbë gjithë punërat u shoh juve se jini me të-tepërë hie-lutës. ²³ Sepse, dyke shkuarë e dyke vënë re vëndet' e adhurimit t'uaj, gjeta edhe një altar, përmbi të-cilinë është shkuarë, Mbë Perëndin' e-Panjohurë. Atë pra që nuk' e njihni edhe e adhuroni, këtë po u dëftenj unë juve. ²⁴ Perëndia që bëri botënë edhe gjithë sa **janë** nd'atë, ky, dyke qënë Zot i qjellit edhe i dheut, nukë rri ndër tempuj të-bërë me dorë, ²⁵ As nukë shërbenetë prej duarsh njerësve, sikurse ka nevojë për ndonjë gjë, sepse ay u ep të-gjithëve jetë edhe frymë edhe të-gjitha. ²⁶ Edhe bëri prej një gjaku çdo komp njerëzish, që të rrinë mbi gjithë faqen' e dheut, edhe urdhëroj kohëratë që i ka vënë ndë radhë që përpara, edhe sinorët' e të-ndënjurit t'atyre; ²⁷ Që të kërkonjë Zotinë, mbase muntnjë të a pjekën' edhe t'a gjenjë, ndonëse **ay**

s'është lark prej silitdo prej nesh; ²⁸ Sepse me anë t'ati rojme, edhe lëvizimë, edhe jemi, sikundër edhe ca nga vjershëtorët t'uaj kanë thënë, "Sepse edhe jemi far' e ati." ²⁹ Dyke qënë pra far' e Perëndisë, nukë duhetë të pandejmë se Perëndia ka të-gjarë me ar a me ergjënt a me gur, latuarë me mjeshtëri e çpikje njeriu. ³⁰ Perëndia pra, i-cili nukë vuri re kohërat' e paditjesë, tashi porositi gjithë njërëzitë mbë çdo vënt të pendonenë; ³¹ Sepse ndau një ditë, mbë të-cilënë dotë gjykonjë botënë me drejtëri me anë të një njeriu, të-cilënë e ndau **për këtë**, edhe dha të-vërtetuarë mbë të-gjithë për këtë, dyke ngjallur' atë prej së-vdekurish.

³² Edhe ata kur dëgjuanë të-ngjallurë prej së-vdekurish, ca e përqeshninë, po ca thanë, ³³ Dotë të dëgjojmë përsëri për këtë **gjë**. ³⁴ Edhe kështu Pavli dolli nga mezi i atyreve. Edhe ca burra i ungjitnë, edhe besuanë; ndër mest t'atyre ishte edhe Dhionis Areopagjiti, edhe një grua që quhej Dhamaridhë, edhe të-tjerë bashkë me ata.

Krye 18

¹ Edhe pas këtyre Pavli si iku nga Athina, erdhi ndë Korinthë; ² edhe si gjeti një Judhe që quhej Aqillë, lindurë ndë Pont, e ardhurë rishtazi nga Italia me gruan' e ti Prisqillë, (sepse Kllavdiu kishte urdhëruarë të ikënjënë gjithë Judhenjtë nga Roma,) erdhi tek ata; ³ Edhe passi kishte gjithatë mjeshtëri, mbeti përan' atyreve edhe punonte; sepse mjeshtëria e atyre ishte të bënëjënë tenda. ⁴ Edhe fliste ndë sinagogjiti çdo të-shëtunë, edhe u mbushte mëndjenë Judhenjve e Grekëve.

⁵ Edhe Sila e Timotheu kur sbrinë nga Maqedhonia, Pavli shtrëngonej ndë shpirtt, e epte dëshmim mbë Judhenjtë, se Jisuj është Krishti.

⁶ Po me-qënë-që ata i rrinë kundër edhe shaninë, shkundi rrobat' e tia, e u tha atyre, Gjaku juaj **qoftë** mbi kryet t'uaj; unë jam i-kulluarë; që tashi e **tutje** dotë vete ndëpër kombet.

⁷ Edhe si iku s'andejmi, erdhi ndë shtëpit të një **njeriu** që quhej Just, i-cili druante nga Perëndia, edhe shtëpi' e ati ishte ngjiturë për krahë me sinagogjinë. ⁸ Edhe Krispi i-par' i sinagogjisë, i besoj Zotit me gjithë shtëpin' e ti; edhe shumë veta prej Korinthianëve dyke dëgjuarë besonin' edhe pagëzoshinë. ⁹ Edhe Zoti i tha Pavlit natënë me anë të-fanituri, Mos ufrikëso, po folë, edhe mos pusho; ¹⁰ Sepse unë jam bashkë me ty, edhe asndonjë nukë dotë vërë dorë mbi ty, që të të bënëj keq; sepse kam shumë llaus ndë këtë qytet. ¹¹ Edhe ndënji **atje** një mot e gjashtë muaj, dyke mësuarë atyre fjalën' e Perëndisë.

¹² Edhe kur ishte Galileoni guvernator i Ahaisë, Judhenjtë me një zëmërë ungritnë kundër Pavlit, edhe e prunë ndë gjykatorët, ¹³ Dyke thënë, Se ky u mbush mëndjenë njerësvet të adhuronjë Perëndinë kundër nomit. ¹⁴ Edhe kur Pavli dotë hapënte gojë në Galileoni u tha Judhenjet, Po të ishte ndonjë punë paudhërie a **ndonjë** pun' e-keqe, o Judhenj, dotë kishnjam ngajë t'u duronj juve; ¹⁵ Po ndë është çështje për fjalë e për emëra e për nomnë t'uaj, vështro-e-ni ju vetë; sepse unë s'dua të jem gjykatës i këtyre **punërave**. ¹⁶ Edhe i përzuri ata nga gjykatoreja. ¹⁷ Edhe gjithë Grekëritë zunë Sostheninë, të-parin' e sinagogjisë, edhe e rrihinë, përpara gjykatoresë; Edhe Galileoni asfare s'donte të dinte për këto.

¹⁸ Edhe Pavli, passi priti edhe mjaft dit, u la shëndet vëllezërvet, edhe lundroj për ndë Syri, edhe bashkë me atë Prisqilla edhe Aqilla, passi qethi kryetë ndë Qenhre; sepse e kishte bërë kusht'. ¹⁹ Edhe arriti nd'Efesë, edhe ata i la aty, po vetë hyri ndë sinagogjiti, e fliste me Judhenjtë. ²⁰ Edhe ata i ulutnë të mbetetë më tepërë kohë përan' atyreve, po nuk' ubint; ²¹ Po u la shëndet atyre, dyke thënë, Pa fjalë duhetë t'a bënj të-kremtenë që vjen ndë Jerusolim, edhe dotë kthenem përsëri te

* 18:18 e kishte taksurë

ju, ndë dashtë Perëndia. Edhe lundroj prej Efesësë. ²² Edhe si dolli mbë tokë ndë Qesari, hipi **ndë Jerusalem**, edhe si përshëndoshi kishënë, sbriti ndë Antiohi.

²³ Edhe passi ndënji ca kohë **atje**, dolli e shkonte me radhë ndëpër gjithë vëndin' e Gallatisë edhe të Frygjisë, dyke forcuarë gjithë nxënësitë.

²⁴ Edhe një Judhe që quhej Apollo, lindurë nd'Aleksandri, i-cili ishte njeri i-zoti ndë fjalët edhe i-fortë ndë shkronjat, sbriti ndë Efesë. ²⁵ Ky ishte i-mësuarë ndë udhët të Zotit, edhe i-nxehëtë ndë shpirt, dyke diturë vetëmë pagëzimin' e Joanit. ²⁶ Edhe ky zuri të flasë me kuxim ndë sinagogjit. Edhe Aquila e Prisqilla, kur e dëgjuan' atë, e muarnë me vetëhe, edhe i dëftyen' udhën' e Perëndisë më çkoqurë. ²⁷ Edhe passi donte të shkonjë nd'Ahai, vëllezërit' u shkruanë nxënëset e i këshilloninë t'a presënë; i-cili, kur erdhi, u ndihu shumë atyreve që kishinë besuarë me anë të hirit. ²⁸ Sepse me shumë fuqi u'a sbulonte Judhenjvet ndër syt të botësë, dyke dëftyerë me anë të shkronjavet, se Jisuj është Krishti.

Krye 19

¹ Edhe kur ishte Apolloj ndë Korinthë, Pav-li, passi shkoj ndëpër anët të-sipërme, erdhi ndë Efesë; edhe si gjeti **atje** ca nxënës, ² U tha atyre, A muartë Frymë të-Shënjtëruarë, kur besuatë? Edhe ata i thanë, Po as nukë kemi dëgjuarë ndë ka frymë të-Shënjtëruarë. ³ Edhe ay u tha atyre, Mbë se pra upagëzuatë? Edhe ata i thanë, Ndë pagëzimt të Joanit. ⁴ Edhe Pavli tha, Joani pagëztoj pagëzim pendimi, dyke thënë llauzit t'i besonjëni ati që dotë vinte pas ati, do-me-thënë, Jisu Krishtit. ⁵ Edhe ata si dëgjuanë, upagëzuanë mb'emërit të Zotit Jisu. ⁶ Edhe si vuri Pavli duartë mbi ata, erdhi frym' e-Shënjtëruarë mbi ata, edhe flisninë gjuhëra e profitesninë. ⁷ Edhe gjithë këta ishinë sindonja dy-mbë-dhjetë burra.

⁸ Edhe si hyri ndë sinagogjit, u fliste me kuxim, dyke kuvënduarë tre muaj me radhë, e dyke mbushurë mëndjen' atyre për punët' e mbretëris' së Perëndisë.

⁹ Po ca nga ata passi ashpëroneshinë e s'u mbushej mëndja, edhe flisninë keq për udhën' e Zotit përpara gjindjesë, ulargua nga ata, edhe ndau nxënësitë, dyke kuvënduarë përdita ndë skolit të njëj **që quhej** Tyran. ¹⁰ Edhe këjo ubë dy vjet me radhë; kaqë sa gjith' ata që rrininë nd'Asi, Judhenj e Grekër, dëgjuanë fjalën' e Zotit (Jisu). ¹¹ Edhe çudira të-mëdha bënte Perëndia me anë të duarvet të Pavlit, ¹² Kaqë sa edhe mbi të-sëmuret shpininë mafesë a përparje nga trupi i ati, edhe sëmurdjetë ikninë nga ata, edhe frymat' e-liga dilninë nga ata.

¹³ Edhe ca nga ata Judhenjtë përgjërimtarë që vininë vënt mbë vënt zunë të zënë n'gojë emërin' e Zotit mb'ata që kishinë fryma të-liga, dyke thënë, U përgjërojmë juve mbë atë Jisunë që lëçit Pavli. ¹⁴ Edhe ata që bëninë këtë ishinë shtatë bij të një Judheu kryeprift **që quhej** Sqeva. ¹⁵ Edhe frym' e-ligë upërgjeq e tha, Jisun' e njoh, edhe Pavlin' e di; po ju cilëtë jini? ¹⁶ Edhe ay njeriu, tek i-cili ishte frym' e-ligë, u hoth mbi ata, edhe si i mundi, dolli i-fortë kundr' atyreve kaqë sa **ata** lakuriq e të-plagosurë iknë prej shtëpis' s'ati. ¹⁷ Edhe këjo ubë e-diturë mbë të-gjithë Judhenjt' e Grekëritë që rrininë nd'Efesë; edhe ra frikë mbë gjith' ata, edhe madhëronej emëri i Zotit Jisu. ¹⁸ Edhe shumë nga ata që kishinë besuarë vininë dyke rrëfyerë e dyke treguarë punët' e tyre, ¹⁹ Edhe mjaft veta nga ata që bëninë magjijtë bininë librat' e tyre, e i diqninë përpara të gjithëve; edhe passi numëruanë të-çëmuarat' e atyreve, i gjetnë **se vëjeninë** pesë-dhjetë mijë **copë** ergjendi. ²⁰ Kështu fort shtonej e forconej fjal' e Zotit.

²¹ Edhe si umbaruanë këto, Pavli e vuri ndër mënt, passi të shkonjë ndëpër Maqedhoni e ndëpër Ahai, të vejë ndë Jerusalem, e tha, Se si të vete atje, duhetë të shoh edhe Romënë. ²² Edhe dërgoj ndë Maqedhoni dy veta nga ata që i shërbeninë, Timothënë edhe Erastinë, po ay vetë mbeti ca kohë nd'Asi.

²³ Edhe nd'atë kohë ubë jo pak trazyrë për **këtë** udhë. ²⁴ Sepse një argjëndar që quhej Dhimitër, dyke bërë tempuj t'ergjënttë të Artemidhësë, u epte mjeshtërvet jo pak fitim. ²⁵ **Ky** si mbloodhi këta, edhe ata që punonin të-këtitlatë, tha, O burra, dini mirë se prej kësaj pune është pasja jonë; ²⁶ Edhe vini re e dëgjoni, se shumë llauzi jo vetëmë të Efesësë, po edhe të gjithë Asisë pothua, ky Pavli u mbushi mëndjenë e i ktheu, dyke thënë, se nuk janë perëndira ata që bënenë me duar. ²⁷ Edhe jo vetëmë këjo mjeshtëria jonë është mbë rrezik të bjerë poshtë, po edhe tempulli i perëndeshës' së-madhe Artemidhë të mos zihetë për gjë, edhe dotë humbasë madhëria e asaj, të-cilënë gjith' Asia edhe bota e nderon.

²⁸ Edhe **ata** kur dëgjuanë, umbushnë me zëmërim, e bërtisinë dyke thënë, E-madhe **është** Artemidha e Efesianëvet. ²⁹ Edhe tërë qyteti umbush me trazyrë; edhe si rrëmbyenë Gainë edhe Aristarhunë, **njerës** Maqedhonas që ishinë shokë të-Pavlit ndë **këtë** udhë, usulnë me një zëmërë ndë theatrët. ³⁰ Edhe Pavli kur donte të hynjë ndë mest të gjindjesë, nxënësitë nuk' e lininë. ³¹ Edhe ca nga të-mëdhenjt' e Asisë, që ishinë miq t'ati, dërguanë tek ay edhe i luteshinë të mos dalë ndë theatrët. ³² Të-tjerë pra thërrisinë **për** një gjë, e **të-tjerë për tjetërë**; sepse përmbledhja ishte trazuarë fort, edhe më të-shumëtë nukë dininë për se ishinë mbledhurë.

³³ Edhe prej gjindjesë nxuarnë përpara Aleksandrinë **që të fliste**, sepse Judhenjtë e kishinë vënë përpara, edhe Aleksandri tundi dorënë e deshi t'i apë fjalë gjindjesë. ³⁴ Po passi e njohinë se është Judhë, ubë një zë nga të-gjithë, dyke bërtiturë afëre dy orë, E-madhe **është** Artemidha e Efesianëvet.

³⁵ Edhe shkronjësi i **qytetit**, si sbuti gjindjenë, thotë, O burra Efesianë, cili është ay që nukë di, se qytet' i Efesianëvet i shërben tempullit të perëndeshës' së-madhe Artemidhë edhe idhullit që sbriti nga Enjëti? ³⁶ Passi pra këto janë të-pakundrështuarshimë, ju duhetë të rrii urtë, e asgjë të mos bëni me të-rrëmbyerë. ³⁷ Sepse keni prurë këta njerës, të-cilëtë as gjë kishë kanë vjedhurë, as perëndeshënë t'uaj kanë sharë. ³⁸ Ndë qoftë pra se Dhimitri edhe mjeshtëritë që janë bashkë me atë kanë fjalë kundrë ndonjë **njeriu**, ka dit gjyqi, ka edhe gjykatës; letë ngenë njeri tjatrinë. ³⁹ Po ndë kërkoni gjë për të-tjera çështje, **këjo** dotë sgjidhetë ndë përmbledhjet që është pas nomit. ⁴⁰ Sepse jemi ndënë rrezik të përflitemi si krye-ngritës për trazyrën' e-sotme, sepse s'ka ndonjë farë ngaje me anë të së-cilësë të muntnjëmë të apëmë fjalë për këtë trazyre. Edhe dyke thënë këto, lëshoj përmbledhjenë.

Krye 20

¹ Edhe passi pushoj trumbullimi, Pavli thërriti nxënësit' e upërshtëndosh me ata, edhe doli të vejë ndë Maqedhoni. ² Edhe si shkoj ndëpër ato anë, e i ngushëlloj me shumë fjalë, erdhi ndë Greqi.

³ Edhe bëri atje tre muaj. Edhe passi ubë kundr' ati prej Judhenjet një pritë, kur ishte për të lundruarë për ndë Syri, uvendos të kthenetë me anë të Maqedhonisë. ⁴ Edhe i vate pas gjer nd'Asi Sopatër Verieasi; edhe nga Thessallonikasitë Aristarhu edhe Sekundi edhe Gaiu nga Derva, edhe Timotheu; edhe nga Asianëtë Tyhiku edhe Trofimi. ⁵ Këta vanë më parë, edhe na prisninë ndë Troadhë. ⁶ Edhe neve lundruamë ndë Filipëtë pas ditvet të pabrumjvet, edhe për pesë dit erthmë tek ata ndë Troadhë, ku ndënjmë shtatë dit.

⁷ Edhe **ditën'** e-parë të javësë, kur ishinë mbledhurë (nxënësitë) për të thyerë bukënë, Pa-vli kuvëndonte me ata, sepse kishte për të ikurë mbë të-nesërmet; edhe e sgjati fjalënë gjer ndë mest të natësë. ⁸ Edhe ndë dhomët të-sipërme, **atje** ku ishinë mbledhurë, ishinë mjaft qirinj të-ndezurë. ⁹ Edhe një djalosh që quhej Eftyh, dyke ndënjurë mbi parathiret, e mori një gjum' i-rëndë, tek po kuvëndonte

Pavli gjer' e gjatë, edhe si e zuri gjumi, ra përposh prej patit të-tretë, edhe e ngritnë të-vdekurë. ¹⁰ Edhe Pavli, si sbriti, ra mbi atë, edhe, si e pushtoj, tha Mos trumbullohi; sepse shpirti i ati është nd'atë. ¹¹ Edhe si hipi e theu bukë e hëngri, e foli mjaft gjer mbë të-sbardhëlluerit, pastaj shkoi. ¹² Edhe prunë djalinë të-gjallë, edhe ungushëlluanë fort tepërë.

¹³ Edhe neve vamë më parë ndë lundrët, edhe lundruamë për ndë Assë, edhe andej dotë merrni-më Pavlinë; sepse kështu kishte porositurë, sepse ay donte të vij mbë këmbë. ¹⁴ Edhe si u poq me ne nd'Assë, e muarm' e erthmë ndë Mitylinë; ¹⁵ Edhe që andej lundruamë, edhe mbë të-nesërmet erthmë kundruell Hiosë; edhe **ditënë** tjetërë arritmë ndë Samë; edhe si mbetnë ndë Trogjiyli, mbë të-nesërmet erthmë ndë Militë. ¹⁶ Sepse Pavli e kishte parë të udhësë të lundronjë ndëpër anët të Efesësë **pa dalë atje**, që të mos e humpte kohënë nd'Asi; sepse nxitonte, ndë ishte e-mundurë **punë** për atë, ditën' e Pentikostisë të gjendetë ndë Jerusalem.

¹⁷ Edhe prej Militësë dërgoj nd'Efesë, e thirri pleqt' e kishësë. ¹⁸ Edhe **këta** kur erthnë tek ay, u tha atyre, Ju e dini që ditën' e parë që shkela ndë Asi, se qysh e shkova gjithë kohënë bashkë me ju, ¹⁹ Dyke shërbyerë Zotit me çdo zëmërë të-përunjurë e me shumë lot e me ngasje, të-cilatë më gjanë me anë të këshillavet të-liga të Judhenjet kundrë meje; ²⁰ **Edhe** se nukë fsheha gjë nga ato që ishinë për të-mirënë **t'uaj**, po u'a dëfteva juve, e u'a mësova juve ndër syt të botësë e ndëpër shtëpirat, ²¹ Dyke dhënë dëshmim mbë Judenj e mbë Grekër për pendimnë mbë Perëndinë, edhe për besënë mbë Zotinë t'ënë Jisu Krisht. ²² Edhe tashi ja unë tek po vete ndë Jerusalem lidhurë ndë shpirtt, pa mos diturë seç punëra më kanë për të gjarë nd'atë, ²³ Përveç se Frym' e-Shënjtëruarë ep dëshmim mbë çdo qytet, dyke thënë, se po më presënë të-lidhura e shtrëngime. ²⁴ Po s'dua të di asfare për ndonjë **nga këto**, as jetënë s'e kam të-çëmuarë ndë vetëhet t'ime **kaqë**, sa të mbaronj udhënë t'ime me gëzim, edhe atë shërbesënë që mora prej Zotit Jisu, të ap dëshmim për ungjillin' e hirit të Perëndisë. ²⁵ Edhe tashi ja unë tek e di, se më s'e kini për të parë faqenë t'ime ju të-gjithë, ndë mest të të-cilëvet shkova dyke lëçiturë mbretërin' e Perëndisë. ²⁶ Përandaj ap dëshmim mbë ju sot mbë këtë ditë, se unë jam i-qëruarë nga gjaku i të-gjithëve. ²⁷ Sepse unë nuk' uhoqa që të mos u rrëfenj juve gjithë ëndën' e Perëndisë. ²⁸ Kini pra kujdes për vetëhenë t'uaj, edhe për gjithë tufënë, mbë të-cilënë Frym' e-Shënjtëruarë u vuri juve kujdestarë, që të kullotni kishën' e Perëndisë, të-cilën' e fitoj me gjakun e ti. ²⁹ Sepse un' e di këtë, se pas të-ikurit t'im kanë për të hyrë ndër ju ujqër të-këqinj, të-cilëtë s'e kanë për të kursyerë tufënë. ³⁰ Edhe prej jush vetë dotë ngrihenë njerës dyke folurë **gjërëra** të-shtrëmbëra, që të heqënjënë nxënësitë pas vetëhes' së tyre. ³¹ Përandaj rrii sgujarë, e sillni ndër mëntt, se tre vjet nat' e ditë s'pushova dyke mësuarë me lot gjithë-sicilinë. ³² Edhe tashi, o vëllezër, u lë juve te Perëndia, edhe te fjal' e hirit t'ati, i-cili munt t'u ndërtonjë e t'u ap juve trashëgim ndër mest të gjith' atyreve që janë të shënjtëruarë. ³³ Ergjënt a ar a robë as prej ndonjëj **prej jush** nukë dëshërova. ³⁴ Edhe ju vetë e dini, se këto duart' e mia kanë punuarë për nevojat' e mia edhe për ata që ishinë bashkë me mua, ³⁵ Mbë të gjithë **punërat** u dëfteva juve, se kështu dyke munduarë duhetë t'u ndihni të-pafuqishimvet, edhe të kujtoni fjalët' e Zotit Jisu, se ay vetë tha, "M'e-madhe lumëri është të apë **njeriu** se të marrë."

³⁶ Edhe si tha këto, uunj mbë gjunjë, e ufal bashkë me ata të-gjithë. ³⁷ Edhe ata të-gjithë qanë mjaft, edhe ranë mbë qafët të Pavlit, edhe e puthninë; ³⁸ Edhe hidhëroneshinë fort për fjalënë që kishte thënë, Se s'kanë për të parë më faqen' e ati. Edhe e përcillinë ndë lundrët.

Krye 21

¹ Edhe si undamë nga ata, lundruam' e dyke marrë udhënë drejt erthmë ndë Ko, edhe ditënë tjetërë ndë Rodhë, edhe që andej ndë Patara. ² Edhe si gjetmë një lundrë që kishte për të shkuarë ndë Finikë, hipmë **mb'atë** e lundruamë. ³ Edhe kur pamë për së-largu Qyprënë, edhe e lamë mbë të-mëngjërë, lundruamë për ndë Syri, edhe duallmë ndë Tyrë; sepse atje lundra kishte për të çkarkuarë barrën' **e saj**. ⁴ Edhe si gjetmë nxënësitë, mbetm' atje shtatë dit; edhe ata i thoshinë Pavlit me anë të Frymësë, që mos hipënjë ndë Jerusolim. ⁵ Edhe si mbaruam' **ato** dit, duallm' e shkonimë, edhe **ata** të-gjithë me gra e me fëmijë na përcillinë gjer jashtë qytetit; edhe si uunjmë mbë gjunjë ndë buzët të detit, ufalmë. ⁶ Edhe si përshëndoshmë njëri tjetrinë hipmë ndë lundrët, edhe ata ukthyenë ndëpër **shtëpirat** të tyre.

⁷ Edhe neve si mbaruamë të-lundruarëtë prej Tyrësë arritmë ndë Ptolemaidhë, edhe si përshëndoshmë vëllezëritë, mbetmë një ditë përan' atyreve. ⁸ Edhe mbë të-nesërmet (neve që ishimë bashkë me Pavlinë) duallm' e erthmë ndë Qesari, edhe si hymë ndë shtëpit të Filipp Ungjiltarit, që ishte një nga të shtatëtë, mbetmë përan' ati. ⁹ Edhe ky kishte katrë bija virgjëresha që profitepsninë. ¹⁰ Edhe tek ishimë ne dyke mbeturë **atje** mjaft dit, sbriti nga Judhea një profit që quhej Agaf; ¹¹ Edhe si erdhi ndër ne, mori brezin' e Pavlit, edhe si lidhi duart' e këmbët' e tia tha, Këto thotë Frym' e-Shënjtëruarë, Kështu dota lithnjënë Judhenjtë ndë Jerusolim atë burrë, i të-cilit është ky bres, edhe dot'a apënë ndër duart të kombevë. ¹² Edhe kur dëgjua më këto, i luteshimë edhe ne edhe vëndësitë të mos hipënjë ay ndë Jerusolim. ¹³ Po Pavli upërgjeq, Ç'bëni kështu dyke qarë e dyke copëtuarë zëmërenë t'ime? sepse unë jam gati jo vetëmë të lidhem, po edhe të vdes ndë Jerusolim për emërin' e Zotit Jisu. ¹⁴ Edhe passi nuk' i mbushej mëndja, pushuamë, dyke thënë, Letë bënë të dashurimi i Zotit. ¹⁵ Edhe pas këtyre ditve bëmë gati plaçkatë e hipmë ndë Jerusolim. ¹⁶ Edhe erthnë bashkë me ne edhe ca nxënës nga Qesaria, edhe prunë një farë Mnasoni Qyprian, një nxënës të-vjetërë, ndë shtëpit të të-cilit dotë binimë.

¹⁷ Edhe neve si erthmë ndë Jerusolim, vëllezëritë na pritnë me gëzim. ¹⁸ Edhe **ditënë** tjetërë Pavli vate bashkë me ne te Jakovi; edhe erthnë gjithë pleqtë. ¹⁹ Edhe si përshëndoshi ata, u dëftente atyre një nga një **gjithë** sa bëri Perëndia ndër kombet me anë të shërbesës' s'ati. ²⁰ Edhe ata kur dëgjuanë, lavduroninë Zotinë; edhe i thanë, Sheh, o vëlla, sa shumë mijëra Judhenjç janë që kanë besuarë; edhe të-gjithë janë zilitarë të nomit. ²¹ Edhe muarnë vesh për ty, se mëson gjithë Judhenjtë që janë ndër kombet të largonenë prej **nomit** të Moisiut, dyke thënë, të mos rrethpresnjë djemtë, as të mos ecënjë pas zakonevet. ²² Çë pra? Pa fjalë shumica dotë mblidhetë, sepse dotë dëgjonjënë, se ke ardhur. ²³ Bëj pra këtë që të themi. Janë ndër ne katrë burra, që kanë kusht mbi vetëhet të tyre; ²⁴ Merr këta edhe qërohu bashkë me ata, edhe prish për ata, që të ruanjënë kryetë, edhe të-gjithë t'a dinë se s'janë gjë ato që kanë dëgjuarë për ty, po **se** edhe **ti** vetë je dyke ruajturë gjithënjë nomnë? ²⁵ Sa për ata kombetë që kanë besuarë, neve u shkruajtmë, passi e pamë të udhësë ata të mos ruanjënë asgjë të-këtille, veç të ruhenë prej kurbanëvet të idhujvet edhe prej gjakut edhe prej gjës' së-mbyturë edhe prej kurvërisë. ²⁶ Atëhere Pavli mori me vetëhe **ata** burratë, edhe ditënë tjetërë, si uqërua bashkë me ata, hyri ndë hieroret, edhe ep zë, kur mbushenë ditt' e të-qëruarit, kur dotë bihej dhurëti për sicilinëdo nga ata.

²⁷ Edhe kur ishinë për të mbushurë të shtatë dittë, ata Judhenjtë që ishinë nga Asia, kur e pan' atë ndë hieroret, përzenë gjithë gjindjenë, edhe vunë duartë mbi atë, ²⁸ Dyke bërtiturë, O burra Israilitë, ndih-na-ni; ky është' ay njeriu që mëson kudo

gjithë **njerëzitë** kundrë llauzit edhe nomit edhe këti vëndi; edhe përmbi këto edhe Grekër kalli ndë hieroret, edhe pëgëri këtë vënt të-shënjtëuarë. ²⁹ (Sepse) kishinë parë më parë Trofim Efesianinë bashkë me atë ndë qytett, të-cilinë pandehninë se Pavli e kishte kallurë ndë hieroret. ³⁰ Edhe utunt gjithë qyteti, edhe u-mbloth llauzi; edhe si zunë Pavlinë, e hoqnë jashtë hieroresë; edhe për-një-here umbyllnë dyertë.

³¹ Edhe tek kërkoninë t'a vrsininë, vate fjala te kryemijësi i tufës' s'ushtëtorëvet, se gjithë Jerusalmi është përzjerë; ³² I-cili për-një-here mori me vetëhe ushtëtorë e kryeqindës, e usul poshtë mbi ata. Edhe ata kur panë kryemijësin' edhe ushtëtorët, pushuanë së-rrahuri Pavlinë. ³³ Atëhere kryemijësi uaferua, edhe e zuri, edhe urdhëroj të lidhetë me dy vargje **hekurash**, edhe pyeste, cili ishte **ay**, edhe ç'kishte bërë. ³⁴ Edhe ndër mest të gjindjesë bërtisininë **ca për një**, e të-tjerë për tjetërë **punë**; edhe passi nukë mundi të marrë vesh të-vërtetënë për trazyrënë, urdhëroj të silletë ndë fortesët. ³⁵ Edhe kur erdhi ndë shkallët, për shtrëngatënë nga an' e gjindjesë gjau ushtëtorët t'a mbanjë ndër duart. ³⁶ Sepse shumic' e llauzit vinte pas dyke bërtiturë, Ngrij-e atë.

³⁷ Edhe Pavli kur dotë hynjte ndë fortesët, i thotë kryemijësit, A më ndjenetë diç të të them? ³⁸ Edhe ay tha, A di Gërqišt? Vallë mos je ti ay Egjyptiani, që ngriti krye para këtyre ditve edhe nxori ndë shkretëtirët katrë mijë njerës gjakëso-rë? ³⁹ Edhe Pavli tha, Unë jam një njeri Judhe nga Tarsa, qytetës i një qyteti me emërë të Qiliqisë; edhe të lutem, ep-më lejë t'i flas llauzit. ⁴⁰ Edhe ay si i dha lejë, Pavli qëndroj mbi shkallët, i bëri llauzit shënjë me dorë edhe si ubë pushim i-math, foli ndë gjuhë Ebraishte, dyke thënë,

Krye 22

¹ O burra vëllezër edhe atër, pa më dëgjoni dyke drejtëuarë vetëhenë t'ime përpara jush. ² (Edhe kur dëgjuanë, se u fliste atyre ndë gjuhë Ebraishte, pushuanë më tepërë; edhe thotë,)

³ Unë jam një njeri Judhë, lindurë ndë Tarsë të Qiliqisë, edhe rriturë ndë këtë qytet për-anë këmbëvet të Gamaliilit, mësuarë me kujdes ndë nomt të atërvet, edhe ishnjam zilltar për Perëndinë, sikundrë ju të-gjithë jeni sot; ⁴ Edhe këtë udhë e ndoqa gjer mbë vdekje dyke lidhurë e dyke dhënë ndër burgje burra e gra; ⁵ Sikundrë edhe kryepriifti ep dëshmim për mua, edhe gjithë pleqësia; prej të-cilëvet mora edhe kartëra për vëllezëritë, e vinja ndë Dhamaskë, që të binja të-lidhurë edhe ata që ishin' atje, që të mundoneshinë. ⁶ Edhe dyke bërë udhë tek afëronesha ndë Dhamaskë, afëro nga mesi i ditësë, papandehuraj prej qielli vetëtiti një drit' e-madhe rreth meje; ⁷ Edhe **unë** rashë përdhe, edhe dëgjova një zë që më thoshte Saull, Saull, përse më ndjek? Edhe un' upërgjeqçë, Cili je **ti**, o Zot? ⁸ Edhe ay më tha, Unë jam Jisu Nazoreasi, të-cilinë ti ndjek. ⁹ Edhe ata që ishinë me mua dritën' e panë edhe utrëpnë fort; po zën' e ati që më fliste nuk' e dëgjuanë. ¹⁰ Edhe **unë** thashë, Ç'të bënë o Zot? Zoti më tha, ngrëu edhe shko ndë Dhamaskë; edhe atje dotë të flitetë për gjithë sa jan' urdhëruarë të bënëç. ¹¹ Edhe passi nukë shihnjam nga ndriçim' i asaj drite, dyke uhequrë prej dore nga ata që ishinë bashkë me mua erdha ndë Dhamaskë.

¹² Edhe një farë Ananie, njeri besëtar pas nomit, e me dëshmim të-mirë prej gjithë Judhenjvet që rrinin' **atje**, ¹³ Erdhi tek unë edhe ndënji përpara, e më tha, Saull, o vëlla, hap sytë; edhe unë ndë gjithatë orë hapa sytë edhe e pash' atë. ¹⁴ Edhe ay tha, Perëndia i atërvet t'anë të sgjodhi të njohç dashurimn' e ati, edhe të shoqç të-Drejtinë, edhe të dëgjonjç zë prej gojës' s'ati; ¹⁵ Sepse dotë jesh dëshmimtar i ati mbë gjithë njerëzitë për sa pe e dëgjove. ¹⁶ Edhe tashi ç'sillesh? ngrëu e pagëzohu, e lahu nga fajet' e tu, dyke thërriturë emërin' (e Zotit).

¹⁷ Edhe passi ukthyeshtë ndë Jerusalem, tek ishnjam dyke falurë ndë hieroret, arçë mbë të-habiturë, ¹⁸ Edhe e pash' atë dyke thënë mua, Nxito, edhe dil çpejt nga Jerusalem; sepse s'e kanë për të priturë dëshmimnë t'ënt për mua. ¹⁹ Edhe unë thashë, Zot, ata e dinë, se unë ishnjam ay që vinjam ndë burk e që rrihnjam ndëpër sinagogjit ata që besoninë mbë ty. ²⁰ Edhe kur derdhej gjaku i Stefanit, dëshmimtarit t'ënt, edhe unë vetë ishnjam atje përpara, e dyke pëlqyerë vrasjen' e ati, edhe ruanjam rrobat' e atyreve që e vrisninë. ²¹ Edhe më tha, Shko; se unë të kam për të dërguarë ndër kombe lark.

²² Edhe gjer mbë këtë fjalë e dëgjoninë; po **atëhere** ngritnë zën' e tyre, dyke thënë, Ngrij-e prej dheut të-tillinë **njeri**; sepse nukë duhetë të rronjë. ²³ Edhe me-qënë-që ata bërtisininë, edhe shkuntninë rrobat' e tyre edhe hithninë pluhurë ndëpër erët, ²⁴ Kryemijësi urdhëroj të sillëtë ndë fortesët, edhe tha t'a pyesënë me të-rrahura, që të marrë vesh për ç'ngajë bërtisininë kështu kundrë ati. ²⁵ Edhe si e shtriti të-lidhurë me ripa, Pavli i thotë kryeqindësit që rrinte atje, Eshtë vall' e udhësë mbë ju të rrihi një njeri Roman, edhe pa gjykuarë? ²⁶ Edhe kryeqindësi kur dëgjoj **këto**, vate e i dëfteu kryemijësit, dyke thënë, (Shiko) ç'je dyke bërë; sepse ky njeri është Ro-man. ²⁷ Edhe kryemijësi erdhi e i tha, Thuaj-më, Roman je ti? Edhe ay tha, Po. ²⁸ Edhe kryemijë-si upërgjeq, Unë me shumë aspra e fitova të-drejtnë' e të-qënurit qytetës **Roman**. Edhe Pavli tha, Po unë edhe kam lindurë **Roman**. ²⁹ Për-një-herë pra uhoqnë prej ati ata që dot'a mundoninë. Po edhe kryemijësi ufrikësua, se mori vesh, se është Roman, edhe sepse e kishte lidhurë.

³⁰ Edhe mbë të-nesërmet dyke dashurë të marrë vesh të-vërtetënë, për ç'punë përfilitetë nga Judhenjtë, e sgidhi (nga të-lidhuratë), edhe urdhëroj të vinjënë kryepriftërit' edhe gjithë bashkëndënja e atyreve; edhe sbriti Pavlinë, edhe e vuri përpara atyreve.

Krye 23

¹ Edhe Pavli shtyri sytë ndë bashkëndënjet, e tha, O burra vëllezër, unë gjer **sot** mbë këtë ditë kam ecurë përpara Perëndisë me çdo ndërgegjeje të-mirë. ² Edhe kryeprifti Anani urdhëroj ata që rrininë për'an' ati t'i bjenë gojëse. ³ Atëhere Pavli i tha, Perëndia dotë të bjerë, o mur i-lyerë me këlqere; e ti rri të më gjykonjç pas nomit, edhe dyke shkelurë nomnë urdhëron të më bjenë? ⁴ Edhe ata që rrininë për'anë thanë, Kryepriftin' e Perëndisë shan **ti**? ⁵ Edhe Pavli tha, Nuk' e dinja, o vëllezër, se është kryeprift; sepse është shkruarë, "Mos flaç keq për të-parin e llauzit t'ënt".

⁶ Edhe Pavli si e kupëtoj, se njëra pjesë ishte prej Sadduqenjsh, edhe tjetëra prej Farisenjsh, bërtiti ndë bashkëndënjet, O burra vëllezër, Unë jam Farise, e bir Fariseu; unë po gjykonem për shpresë e për të-ngjallurit' e të-vdekurvet. ⁷ Edhe si foli ay këtë, ubë një zënëndë ndë mest të Farisenjvet e të Sadduqenjjet, edhe shumica unda **mbë dy**. ⁸ Sepse Sadduqenjët thonë se s'ka të-ngjallurë, as ëngjëll, as frymë; po Farisenjtë i rrëfenjënë që të dyja. ⁹ Edhe ubë një trazyr' e-madhe, edhe shkronjësit' e anës' së Farisenjvet ungritnë e ziheshinë, dyke thënë, Asgjë të-keqe s'gjejmë te ky njeri; po ndë i foli ati **ndonjë** frymë a ëngjëll, letë mos luftojmë kundrë Perëndisë. ¹⁰ Edhe passi ubë trazyr' e-madhe, kryemijësi pati frikë se mos çqyhetë Pavli prej atyre, edhe urdhëroj të sbresë ushtëria e t'a rrëmbenjë nga mezi i atyreve, edhe t'a shpjerë ndë fortesët.

¹¹ Edhe natënë pas asaj **dite** i udhëq Zoti e i tha, Kij zëmërë, Pavël, sepse sikundrë dëshmove për mua ndë Jerusalem, kështu duhetë të dëshmojsh edhe ndë Romë.

¹² Edhe si ubë ditë, ca nga Judhenjtë ulitnë me be ndë mest të tyre e nëmnë vetëhen' e tyre, dyke thënë, as të mos hanë as të mos pinë, gjersa të vrasënë

Pavlinë. ¹³ Edhe ata që kishinë bërë këtë lidhje me be ishinë më shumë se dyzet **veta**; ¹⁴ Të-cilëtë erthnë te kryepfritërit' edhe te pleqtë, e thanë, Me nëmë kemi nëmurë vetëhenë t'ënë të mos ngjëronemi asgjë, gjersa të vrasëmë Pavlinë. ¹⁵ Tashi pra ju me bashkëndënjënë epni zë kryemijësit t'a sbresë nesërë të ju, sikurse doni të merrni vesh më mirë punërat' e ati; edhe neve, para se të afëronet' ay, jemi gati t'a vrasëmë.

¹⁶ Po si dëgjoj këtë pritë i bir' i së motrës' së Pavlit, vate e hyri ndë fortesët, e i dëfteu Pavlit. ¹⁷ Edhe Pavli thërriti një nga kryeqindësitë, e tha, Shpier-e-ni këtë djalosh te kryemijësi; sepse diç i ka për të thënë ati. ¹⁸ Ay pra si e mori me vetëhe, e pruri te kryemijësi, edhe thotë, Pavli që është ndë burk më thirri, e **m'**ulut të bje këtë djalosh te ti, sepse diç të ka për të folurë ty. ¹⁹ Edhe kryemijësi si e mori prej dore, edhe uhoq mbë një anë, e pyeste, Ç'është **ajo** që më ke për të dëftyerë? ²⁰ Edhe ay tha, Se Judhenjtë lithnë fjalë të të lutenë që nesërë t'a sbrëç Pavlinë ndë bashkëndënjët, sikurse kanë për të pyeturë gjë më çkoqurë për atë; ²¹ Po ti mos udëgjo atyre; sepse e presënë ndë pritë atë më shumë se dyzet **veta** prej atyreve, të-cilëtë kanë nëmurë vetëhen' e tyre, as të mos hanë as të mos pinë, gjersa t'a vrasën' atë; edhe tashi janë gati dyke priturë fjalë prej teje.

²² Kryemijësi pra e lëshoj djaloshinë, dyke porositurë atë, Mos i thuajsh asnjëri se më dëfteve këto. ²³ Edhe thirri dy veta nga kryeqindësitë, e u tha atyre, Bëni gati dy qint ushtëtorë për të vajturë gjer ndë Qesari, edhe shtatë-dhjetë kalorës, edhe dy qint shtizorë, që mbë të-tretënë orë të natësë. ²⁴ Bëni gati edhe kafshë, që të hipënjënë Pavlinë, e t'a shpenjë me siguri te Filik qivernitari. ²⁵ Edhe shkroj një kartë që kishte këto fjalë:

²⁶ "Kllavdiu Lysi mbë të-pushtëçiminë qivernitar Filik, gëzuash. ²⁷ Këtë njeri që uzu prej Judhenjet, edhe dotë vritej prej atyre, **unë** arrita bashkë me ushtërinë edhe e shpëtova, sepse mora vesh se është Roman. ²⁸ Edhe dyke dashurë të marr vesh për ç'ngajë e përfllisninë, e sbrita ndë bashkëndënjët t'atyre; ²⁹ Edhe gjeta se përfllitej për çështje të nomit t'atyre, po s'ka ndonjë faj për vdekje a për të lidhurë me hekura. ³⁰ Edhe passi më dhanë zë, se dotë bënej pritë prej Judhenjet kundrë njeriut, për-një-here e dërgova te ti, edhe porosita edhe ata që e përfllasën' atë të thonë përpara teje ç'fjalë kanë kundr' ati. Qofsh me shëndet."

³¹ Ushtëtorëtë pra, sikundrë qenë urdhëruarë, muarnë Pavlinë, edhe e prunë natënë ndë Antipatridhë. ³² Edhe mbë të nesërmet, si lanë kalorësitë të venë bashkë me atë, ukthyenë ndë fortesët; ³³ Të-cilëtë si hynë ndë Qesari edhe dhanë kartënë ndë dorët të qivernarit, nxuarnë përpara ati edhe Pavlinë. ³⁴ Edhe qivernitari si këndonj **kartënë**, edhe pyeti nga ç'vënt është, edhe kur dëgjoj, se është nga Qiliqia, ³⁵ Dotë të dëgjonj, tha, kur të vinjën' edhe ata që të përfllasënë. Edhe urdhëroj të ruhetë ndë gjykatoretë të Irodhit.

Krye 24

¹ Edhe pas pesë ditsh sbriti kryepfriti Anani bashkë me pleqtë e me një farë fjalori **që quhej** Tertyl, të-cilëtë duallnë përpara qivernitarit kundrë Pavlit. ² Edhe si uthirr ay, Tertyli zuri të përfllasë, dyke thënë, ³ O i-pushtëçim Filiiks, shumë prëhje kemi me anë t'ënde, edhe punëra të-mëdha bënenë mbë këtë komp me anë të parëkupëtimit t'ënt përherë edhe mbë çdo vënt, edhe përëndaj presëmë **këto** me shumë të-falura ndersë. ⁴ Po që të mos të rëndonj tepërë, të lutem të na dëgjonj pak fjalë me butësirënë t'ënde. ⁵ Passi e gjetmë këtë njeri se **është** murtagjë, edhe se ngre trazyrë ndër mest të gjithë Judhenjvet që janë ndëpër botët, edhe se është i-pari i sektës' së Nazoreaset, ⁶ I-cili edhe hierorenë deshë t'a ndyrnjë; të-cilën' edhe e zumë, edhe deshëmë t'a gjykojmë pas nomit t'ënë. ⁷ Po erdhi Lysi kryemijësi, edhe na e rrëmbeu prej duarvet me shumë shtrëngim, ⁸ Dyke urdhëruarë që përfllësit' e

ati të vinjënë përpara teje; prej të-cilit ti vetë si t'a pyeç dotë munç të marrç vesh për gjithë këto që e përflasëmë neve. ⁹ Rrëfyenë bashkë **me atë** edhe Judhenjtë, dyke thënë, se këto kështu janë.

¹⁰ Atëhere Pavli, passi i bëri shënjë qivernitarit të flasë, upërgjeq, Passi e di, se prej shumë vietve je gjykatës ndë këtë komp, me zëmërë më të-gëzuarë ap fjalë për vetëhenë t'ime; ¹¹ Sepse munt të marrç vesh, se nukë janë më tepërë se dy-mbë-dhjetë dit që kur se hipa ndë Jerusalem për të falurë. ¹² Edhe as ndë hieroret më gjtnë dyke kuvënduarë me ndonjë **njeri**, a dyke ngriturë më këmbë gjindjenë, as ndëpër sinagogjit, as ndë qytett; ¹³ As munt t'i vërtetonjënë ato gjërëra për të-cilatë më përflasënë ndashti. ¹⁴ Po rrëfenj këtë te ti, se pas udhësë, që **këta** i thonë eresi, kështu adhuronj Perëndin' e atërvet të mi, dyke besuarë mbë gjith' ato që janë shkruarë ndë nomt e ndë profitërit; ¹⁵ Edhe kam mbë Perëndinë shpresë, të-cilënë edhe këta vetë e presënë, se dotë bënë të ngjallurit' e të-vde-kurve, të-drejtëvet e të-shtrëmbërvet. ¹⁶ Edhe për këtë unë po përpiqem, që të kem përherë ndërgjegje pa faj përpara Perëndisë edhe përpara njerësvet. ¹⁷ E-dhe **tashi** pas shumë vjetve erdha për të bërë kombit t'im eleimosina edhe dhurata. ¹⁸ Po ndër mest të këtyre **gjërërave** ca Judhenj nga Asia më gjtnë të-qëruarë ndë hieroret, jo me shumë gjindje, as me trazyrë; ¹⁹ Të-cilëtë duhej të dilninë përpara teje e të më përflisninë, ndë kishinë gjë kundrë meje. ²⁰ A këta vetë letë thonë, ndë gjtnë ndojë të-shtrëmbërë tek unë, kur dolla përpara bashkëndënsesë, ²¹ Veç **ndë qoftë se më përflasënë** për këtë të-vetëmë zë, që thërrita ndë mest t'atyreve, Se për të-ngjallurit' e të-vdekurvet po gjykonem unë sot prej jush.

²² Edhe Filiku (si dëgoj këto), e la gjyqin' e atyre për një tjetërë ditë, sepse i dinte më hollë punërat' e **kësaj** udhe, edhe tha, Kur të sbresë Lysi kryemijësi, dotë marr vesh mirë punëratë t'uaj. ²³ Edhe urdhëroj kryeqindësinë të ruhetë Pavli, edhe të ketë të prëjturë, edhe të mos ndalonjënë ndonjë prej njerëzet të ti t'i shërbenjë a të vinjë tek ay.

²⁴ Edhe pas ca ditsh erdhi Filiku bashkë me gruan' e ti Drusillë, e-cila ishte Judeonjë, edhe dëgoj e thërriti Pavlinë, edhe dëgoj nga ay për besënë mbë Krishtinë. ²⁵ Edhe tek po fliste ay për drejtëri e për të-përmbajturë të vetëhesë edhe për gjyqinë që ka për të ardhurë, Filikut i hyri frikë, e upërgjeq, tashi shko, pa kur të kem kohë, dotë të thërres prapë. ²⁶ Sepse mbë gjithatë kohë edhe shprenjte, se Pavli dot' i epte aspra, që t'a lëshonjë; përandaj më dëndurë e thërriste edhe fliste me atë.

²⁷ Po passi umbushnë dy vjet, Porqiu Fisti erdhi ndë këmbët të Filikut; edhe Filiku, dyke dashurë t'u bënë hir Judhenjet, e la Pavlinë të-lidhurë.

Krye 25

¹ Fisti pra si erdhi ndë vëntt që ishte dhënë ndënë urdhërit **të ti**, pas tri ditsh hipi nga Qesaria ndë Jerusalem. ² Edhe kryepriifti edhe të-parët' e Judhenjet **që ishinë** kundrë Pavlit uduknë përpara ati, ³ Edhe i luteshinë, dyke lypurë hir kundr' ati, që të dërgonjë e t'a bjerë atë ndë Jerusalem, sepse kishinë bërë pritë që t'a vrasënë udhësë. ⁴ Edhe Fisti upërgjeq, se Pavli ruhetë ndë Qesari, edhe se ay vetë kishte për të vaturë çpejt **atje**. ⁵ Letë sbresënë pra, tha, ata që muntjnë prej jush bashkë me mua, edhe ndë ka gjë të-keqe te ky njeri, let'a përflasënë.

⁶ Edhe passi ndënji ndër ata më tepërë se dhjetë dit, sbriti ndë Qesari, edhe mbë të-nesërmet, si ndënji mbë gjykatët, urdhëroj të bihetë Pavli. ⁷ Edhe si erdhi ay, dualinë përpara ata Judhenjtë që kishinë sbriturë nga Jerusalem, edhe thoshinë kundrë Pavlit shumë edhe të-rënda të-përfulura, të-cilatë s'muntninë t'i vërtetoninë. ⁸ Sepse ay për të mbrojturë vetëhenë thoshte, Se as mbë nomn' e Judhenjvet, as mbë hierorenë, as mbë Qesarinë bëra ndonjë faj. ⁹ Po Fisti passi donte t'u bënë

hir Judhenjet, i upërgjeq Pavlit, e tha, A do të hipënç ndë Jerusalem, edhe atje të gjykonesh për këto **punëra** përpara meje? ¹⁰ Edhe Pavli tha, Unë po qëndronj përpara gjykatës' së Qesarit, ku duhetë të gjykonem. Judhenjvet asndonjë të-keqe s'u kam bërë, sikundrë edhe ti e di fort mirë; ¹¹ Sepse, ndë qoftë se kam faj edhe ndë kam bërë ndonjë **punë** për vdekje, nuk' i trëmbem vdekjesë; po ndë mos ka asndonjë gjë nga ato që më përflasënë këta, asndonjë nukë munt të më falnjë tek ata; thërres mbë Qesarinë. ¹² Atëhere Fisti si foli me bashkëndënjënë, upërgjeq, Mbë Qesarinë thërrite **t'i**? te Qesari dotë veç.

¹³ Edhe si shkuanë ca dit, mbreti Agrippë edhe Vernika erthnë ndë Qesari, për të përshëndoshurë Fistinë. ¹⁴ Edhe si ndënjnë atje më shumë dit, Fisti i zuri n'gojesh mbretit punën' e Pavlit, dyke thënë, është një njeri që është lënë këtu i-lidhurë prej Filikut; ¹⁵ Për të-cilinë, kur vajta ndë Jerusalem, uduknë **përpara meje** kryeprihtërit' edhe pleqt' e Judhenjet, e lypnë dënim kundrë ati; ¹⁶ Të-cilëvet upërgjeqçë, se nukë është zakon ndër Romanët të epetë për hir ndonjë njeri ndë vdekje, para se të ketë përpara faqesë ay që përflitetë ata që e përflasënë, edhe para se të marrë kohë të apë fjalë për fajnë e ti. ¹⁷ Passi umblohnë pra ata këtu, pa mënuarë fare mbë të-nesërmet ndënja mbë gjykatët, edhe urdhërova të bihetë njeriu; ¹⁸ Për të-cilinë ata që e përflisinë, si duallnë përpara **meje**, nukë prunë ndonjë të-përfolurë nga ato që mendonjam unë. ¹⁹ Po kishinë kundr' ati ca çështje për hie-lutjen' e tyre, edhe për një farë Jisuj që kishte vdekurë, për të-cilinë Pavli thoshte se irron. ²⁰ Edhe unë, passi s'dinjam seç të bënj mbë një të-tillë çështje, i thashë, ndë do të vejë ndë Jerusalem, edhe atje të gjykonetë për këtë. ²¹ Po passi Pavli thirri të ruhetë për të gjykarë te Perandori, urdhërova të ruhet' ay, gjersa t'a dërgonj te Qesari. ²² Edhe Agrippa i tha Fistit, Desha edhe unë t'a dëgjonj këtë njeri. Edhe ay tha, Nesërë dot'a dëgjonjç.

²³ Mbë të-nesërmet pra, kur erdhi Agrippa edhe Vernika me shumë madhështi, edhe hynë ndë sallët të gjykatoresë bashkë me kryemijësit' e me burrat' e-çquarë të qyetit, Fisti urdhëroj, e upru Pavli. ²⁴ Atëhere Fisti thotë, O mbret Agrippë, edhe gjithë **ju** burratë që jeni këtu bashkë me ne, e shihni këtë **njeri**, për të-cilinë gjithë shumica e Judhenjvet më folnë edhe ndë Jerusalem edhe këtu, dyke bërtiturë, se ay nukë duhetë më të rronjë. ²⁵ Po unë passi gjeta se s'ka punuarë gjë për vdekje, edhe ay vetë thirri mbë Perandorinë, e pashë të udhësë ta dërgonj. ²⁶ Për të-cilinë s'kam asgjë të-vërtetë t'i shkruanj **t'im** Zoti; përandaj e prura atë përpara jush, edhe më tepërë përpara teje, o mbret Agrippë, që të kem seç të shkruanj, passi të bënë të pyeturitë. ²⁷ Sepse më duketë punë pa mënt të dërgonj një njeri të-lidhurë, pa shënuarë edhe të-përfoluratë kundrë ati.

Krye 26

¹ Edhe Agrippa i tha Pavlit, Ke lejë të flaç për vetëhenë t'ëndë. Atëhere Pavli shtriti dorënë edhe epte fjalë;

² O mbret Agrippë, e numëronj vetëhenë t'ime të-lumurë, sepse kam për të dhënë fjalë përpara teje sot për gjithë sa përflitem nga Judhenjtë, ³ Po më tepërë sepse ti i di gjithë zakonët' edhe çështjet' e Judhenjet; përandaj të lutem të më dëgjonjç me zëmërë të-gjerë. ⁴ Jetënë t'ime që prej djalërisë, të-cilinë rrojta që ndë kryet ndër mest të kombit t'im ndë Jerusalem, e dinë gjithë Judhenjtë, ⁵ Sepse më dinë që ndë kryet, (ndë qoftë se duanë të dëshmonjënë,) se rrojta Farise sipas së-drejtësë sektë të fesë s'onë. ⁶ Edhe ndashti rri përpara e gjykonem për shpresën' e të-zotuarit që ubë nga Perëndia mbë atëritë t'anë; ⁷ Ndë të-cilët **të-zotuarë** të dy-mbë-dhjetë farat' e **kombit** t'ënë, dyke adhuruarë **Perëndinë** pa pushim dit' e natë, shprenjënë të arrinjënë; për këtë shpresë përflitem, o mbret Agrippë, prej Judhenjvet. ⁸ Çë? gjë e-pabesuarë gjykonetë ndër ju, se Perëndia

gjall të-vdekurë? ⁹ Sa për mua, unë mendonesha me vetëhenë t'ime, se duhej të bënj shumë punëra kundër emërit të Jisu Nazoreasit; ¹⁰ Të-cilënë **gjë** edhe e bëra ndë Jerusolim, edhe shumë nga shënjtoretë un' i mbylla ndër burgje, passi mora pushtet nga kryepriftëritë; edhe kur vriteshinë, ipnja zë kundër **atyreve**.

¹¹ Edhe shumë herë ndëpër gjithë sinagogjit, dyke munduar' ata, i shtrëngonja të vllasfimisninë; edhe dyke tërbuarë pa masë kundër atyreve, i ndiqnjam edhe gjer ndër të jashtëshmit qytete.

¹² Edhe mbi këto e sipërë, kur po ishnjam dyke vajturë ndë Dhamaskë me pushtet e me porosi nga an' e kryepriftërvet, ¹³ Ndë mest të ditësë udhësë pashë, o mbret, se prej qielli një dritë që e shkonte të ndriturit' e djellit ndriti qark meje edhe atyreve që bëninë udhë bashkë me mua. ¹⁴ Edhe si ramë të-gjithë poshtë, përdhe, dëgjova një zë që më fliste mua e që thoshte ndë gjuhët Ebraishte, Saull, Saull, përse më ndjek? keq për ty është t'u bjesh me shkelme gjëmbavet. ¹⁵ Edhe unë thashë, Cili je **ti**, o Zot? Edhe ay tha, Unë jam Jisuj, të-cilinë ti po ndjek. ¹⁶ Po ngreu, edhe qëndro mbë këmbë të tua; sepse për këtë udukçë tek ti, që të të vë shërbëtuar edhe dëshmitar edhe t'atyreve që pe edhe t'atyreve me të-cilatë dotë dëftenuar mbë ty. ¹⁷ Dyke sgjedhurë ty nga llauzi e nga kombetë, ndër të-cilët ndashti po të dërgonj, ¹⁸ Që të hapç syt' e atyre, që **kështu** të kthenenë nga errësira ndë dritët, edhe nga pushteti i Satanajt te Perëndia, që të marrënë ndjesë fajesh, edhe trashëgim ndër mest të të-shënjtëruarëvet, me anë të besësë mbë mua.

¹⁹ Përandaj, o mbret Agrippë, nuk' ubëshë i-pabindurë ndë këtë të-dukurë prej qiellit, ²⁰ Po lëcinsjam më parë mb'ata të Dhamaskës' e të Jerusalimit, edhe ndëpër gjithë dhen' e Judhesë, edhe **pastaj** ndër kombet, të pendonenë, edhe të kthenenë te Perëndia, dyke punuarë punëra të-vëjyera për pendim. ²¹ Për këto **punëra** Judhenjtë më zunë ndë hieroret e doninë të **më** vrisninë. ²² Po me ndihmënë që m'udha prej Perëndisë po qëndronj gjer mbë këtë ditë, dyke dhënë dëshmim mbë të-math e mbë të-vogëlë, pa thënë gjë **tjetërë** veç ato që folnë profitërit' edhe Moisiu se ishinë për të bërë, ²³ Se Krishti kishte për të pësuarë, **edhe** se i-parë dotë ngjallej prej së-vdekurish, edhe se dotë lëçiste dritë ndër llaust e ndër kombet.

²⁴ Edhe tek po epte ay fjalë kështu për vetëhen' e ti, Fisti tha me zë të-math, Je i-shkalluarë, o Pavël; mësimet' e-shumë të bënë të shkallonjç. ²⁵ Edhe ay tha, Nukë jam i-shkalluarë, o i-pushtëçim Fist, po flas fjalë të-vërteta edhe prej mëndjeje të-shëndoshë. ²⁶ Sepse i di këto **punëra** mbreti, të-cilit edhe i flas me kuxim; sepse jam i-bindurë, se s'ka asndonjë nga këto që të mos e dijë; sepse këjo nuk' është bërë mbë ndonjë çip. ²⁷ A u beson profitërvet, o mbret Agrippë? e di se u beson. ²⁸ Edhe Agrippa i tha Pavlit, për pakëzë mënt më mbush mëndjenë të bënem i-krishterë. ²⁹ Edhe Pavli tha, I lutem Perëndisë të apë, që jo vetëmë ti, po edhe gjith' ata që më dëgjonjënë sot të bënenë nga pak e nga shumë të-tillë si jam edhe unë, përveç këtyre hekurave.

³⁰ Edhe (si tha ay këto), u ngrit mbreti, edhe qivernitari, edhe Vernika, edhe ata që kishinë ndënjurë bashkë me ata. ³¹ Edhe si iknë flisninë njëri me tjetërinë, dyke thënë, Se ky njeri s'ka bërë asndonjë punë për vdekje a për hekura. ³² Edhe Agrippa i tha Fistit, Ky njeri munt të lëshonej, po të mos kishte thirrurë mbë Qesarinë.

Krye 27

¹ Edhe passi upa e udhësë të lundrojmë për ndë Itali, dhanë Pavlinë edhe ca të-lidhurë të-tjerë te një kryeqindës që quhej Jul, prej tufës' së Avgustit. ² Edhe si hipmë ndë një lundrë Adhramitine, ungritmë me mendim të lundrojmë afërë vëndevet t'Asisë; edhe Aristarh Maqedhonasi prej Thessallonikësë ishte bashkë

me ne; ³ Edhe **ditënë** tjetërë arritmë ndë Sidhonë; edhe Juli usull njerëzish mbë Pavlinë, edhe e la të vejë te miqt' **e ti** e të prëhetë. ⁴ Edhe si ungritmë që andej lundruamë ndënë Qyprënë, sepse erëratë ishinë të-kundrejta. ⁵ Edhe si kapëtuamë detn' e Qiliqis' edhe të Pamfylisë, erthmë ndë Myra të Lyqisë. ⁶ Edhe atje kryeqindësi gjeti një lundrë Aleksandriane, që lundronte për ndë Itali, edhe na vuri brënda nd'atë. ⁷ Edhe mjaft dit dyke lundruarë nga dalë mezi arritmë ndë Knidhë, edhe pasi nukë na linte era, lundruamë ndënë Kritënë nga an' e Sallomësë; ⁸ Edhe passi e kaptuam' atë me mundim, erthmë mbë një vënt që quhetë Limanët' e-Mirë, ku afërë ishte qyteti Llasea.

⁹ Edhe passi pat shkuarë mjaft kohë, edhe të-lundruarëtë ndashti ishte të-rrezikshëm, sepse edhe agjërimi ndashti kishte shkuarë, Pavli i këshillonte, ¹⁰ Dyke thënë atyre, O burra, shoh, se këta të-lundruarë dotë bënëtet me të-hequrë keq e me shumë dëm, jo vetëmë të barrës' e të lundrësë, po edhe të jetëvet t'ona. ¹¹ Po kryeqindësi i dëgjonte më tepërë kapedanit edhe të zot të lundrësë se fjalëvet të Pavlit. ¹² Edhe passi limani s'ishte i-mirë për të dimëruarë, më të-shumëtë dhanë këshillë të-ngrihen' edhe që andej, që të arrinjënë, ndë qoftë se muntninë, ndë Finikë, që është një liman i Kritësë që sheh nga jugë-perëndimi e nga veri-perëndimi, edhe **atje** të dimëronjënë. ¹³ Edhe kur fryti pak erë shiu, pandehne, se arritnë dëshirënë, ungritnë, edhe lundroninë përënë **tokës' së** Kritësë.

¹⁴ Po pas pakëzë **here** doli kundrë asaj një erë thëllimi, ajo që quhetë Evrokliodon. ¹⁵ Edhe passi urrëmbye lundra, edhe s'muntte t'i qëndronte erësë, ulam' e biheshimë prej erësë andej e këtej. ¹⁶ Edhe si shkuamë ndënë një ujdhezë të-vogëlë që quhetë Klavdhë, mezi muntmë të vëmë ndënë pushtett t'ënë govatënë; ¹⁷ Të-cilë-në si e ngritnë, përdorinë çdo farë ndihme dyke ngjeshurë lundrënë që përposh; edhe me-qënë-që kishinë frikë semos bjenë ndë shtresë rëre, sbritnë pëlhuratë, edhe kështu biheshinë andej e këtej. ¹⁸ Edhe passi motinë e kishimë fort të-keq, **ditënë** tjetërë derthmë gjënë ndë dett; ¹⁹ Edhe **ditën'** e-tretë i hohtmë plaçkat' e lundrësë me duartë t'ona. ²⁰ Edhe me-qënë-që për shumë dit nukë dukëshinë as djelli as yjtë, edhe moti ishte fort i-keq, më çdo shpresë shpëtimi uhoq prej nesh.

²¹ Edhe si kishinë shumë dit pa ngrënë, atëhere Pavli qëndroj ndë mest t'atyreve, e tha, Duhej, o burra, të më dëgjonitë, edhe të mos ngriheshitë nga Krita, edhe të mos hiqnimë këto të-këqia e këtë dëm. ²² Edhe ndashti u këshillonj juve të kini zëmërë të-gëzuarë; sepse nukë dotë humpnjë asnjë shpirt prej jush, veç lundrësë. ²³ Sepse këtë natë m'uduk një ëngjëll i Perëndisë, i të-cilit jam, të-cilin' edhe adhuronj, ²⁴ Edhe tha, Mos ki frikë, Pavël; ti duhetë të dalç përpara Qesarit; edhe ja Perëndia ty t'i ka falurë gjith' ata që lundronjënë bashkë me ty. ²⁵ Përandaj kini zëmërë të-gëzuarë, o burra; sepse besonj mbë Perëndinë, se kështu dotë jetë, sikundrë më është folurë mua. ²⁶ Edhe duhetë të bjemë jashtë mbë një ujdhezë.

²⁷ Edhe kur erdhi e-katrë-mbë-dhjetëta natë, tek po biheshimë këtu këtë ndë dett Adriatik, si nga mez' i natësë detarëtë sikur kupëtoninë se po afëronënë ndë një tokë. ²⁸ Edhe kur hohtnë skandhallinë, gjetnë njëzet pash **ujë**; edhe si vanë pakëzë më tej, hohtnë edhe prapë skandhallinë, edhe gjetnë pesë-mbë-dhjetë pash; ²⁹ Edhe passi kishinë frikë semos bininë jashtë ndë vënde shkëmbënjsh, hohtnë katrë grepa prej bishtit të lundrësë, edhe luteshinë të bënëtet ditë.

³⁰ Po passi detarëtë kërkoninë të ikëninë nga lundra, edhe sbritnë govatënë ndë dett, me fjalë se sikur dotë hithninë grepa nga ball' i lundrësë, ³¹ Pavli i tha kryeqindësit edhe ushtëtarëvet, Ndë mos ndënjcinë këta ndë lundrët, ju nukë **dotë** muntni të shpëtoni. ³² Atëhere ushtëtorëtë prenë litarët' e govatësë, edhe e lanë të bjerë jashtë.

³³ Edhe gjersa që të bënej ditë, Pavli u lutej gjithëve të hanë gjë, dyke thënë, Sot është e-katër-mbë-dhjetëta ditë që dyke priturë jeni të-urëtë e pa ngrënë gjë. ³⁴ Përandaj u lutem juve të hani gjë; sepse këjo është për shpëtimnë t'uj; se asndonjëj prej jush nukë dot'i bjerë as qime prej kresë. ³⁵ Edhe si tha këto, mori bukë, e i ufal Perëndisë përpara të-gjithëve, edhe si e theu, zuri të hajë. ³⁶ Edhe të-gjithë si muarnë zëmërë, muarnë edhe ata edhe hëngrrë. ³⁷ Edhe ishimë të-gjithë ndë lundrët dy qint e shtatë-dhjet' e gjashtë shpirt. ³⁸ Edhe si unginjë me ushqim, lehtësoninë lundrënë dyke hedhurë grurëtë jashtë ndë dett. ³⁹ Edhe kur ugdhi, nukë e njihninë vëndinë; po vështroninë një gji, që kishte buzë toke, edhe nd'atë umenduanë, po të muntninë, t'a shtininë jashtë lundrënë. ⁴⁰ Edhe si hoqnë lart grepatë, lanë **lundrënë** ndë dett, dyke sgidhurë ndë gjithatë kohë të-lidhurat' e timonëvet; edhe si ngritnë pëlhurën' e-mesme nga frynte **era**, ja mbaninë drej tokësë. ⁴¹ Edhe si ranë ndë një vënt me det nga të dy anëtë, shtynë lundrënë jashtë; edhe ball' i lundrësë, si umbështet, mbeti i-patundurë, po bishti shkallmonej nga të-rrahurit' e-ashpërë të valëvet. ⁴² Edhe ushtërorëtë bënë këshillë të vrisninë të-lidhuritë, që të mos ikënte ndonjë dyke bërë mbë not. ⁴³ Po kryeqindësi dyke dashurë të shpëtonjë Pavlinë, i ndaloj nga këjo këshillë, edhe urdhëroj sa muntninë të bënëmbë not të hidhenë më parë e të dalënë mbë tokët; ⁴⁴ Edhe të-tjerëtë **duallnë**, ca mbi dhoga, e ca mbi **copëra të-thyera** të lundrësë. Edhe kështu shpëtuanë të-gjithë mbë tokë.

Krye 28

¹ Edhe si shpëtuanë, atëhere e njohnë se ujdhesa quhetë Melitë. ² Edhe varvarëtë rrëfyenë mbë ne jo të-pakë mirësi; sepse ndesnë zjarr, e na muarnë brënda të-gjithë, sepse binte shi e ishte ftohëtë.

³ Edhe Pavli kur mblodhi ca shkarpa, edhe i vuri ndë zjarrt, dolli nga të-nxehëtitë një nepërkë e i ungjit ati ndë dorët. ⁴ Edhe varvarëtë si panë bishënë varurë prej dorës' s'ati, i thoshinë njëri tjetërit, Me të-vërtetë ky njeri qënka vrasës, të-cilinë, ndonëse shpëtoj prej detit, gjyqi **i Perëndisë** nuk' e la të rronjë. ⁵ Po ay e shkundi bishënë ndë zjarrt, edhe nukë pësoj ndonjë gjë të-keqe. ⁶ Edhe ata pritninë të ehej a pandehuraj të binte përdhe i-vdekurë; po passi pritninë shumë kohë, edhe shihninë, se asndonjë e-keqe s'i ubë, ndërruanë mëndje, e thoshinë se është perëndi.

⁷ Edhe rreth ati vëndi ishinë ara të të-parit të ujdhesësë që quhej Pupilë, i-cili na priti e na mbajtiti ndë shtëpit miqësisht tri dit. ⁸ Edhe goditi i ati i Pupilit të dergjet' i-sëmurë prej ethesh e prej barku të-keq; tek i-cili Pavli, si hyri, ufal, edhe vuri duartë mbi atë, edhe e shëroj. ⁹ Edhe si ubë kjo, edhe të-tjerëtë sa kishinë sëmundje ndë ujdhesët, vininë **tek ay** edhe shëroneshinë; ¹⁰ Të-cilëtë edhe me shumë ndere na nderuanë, edhe kur ishimë për të ikurë, **na** dhanë ato që kishimë nevojë.

¹¹ Edhe pas tre muajsh ikmë me një lundrë Aleksandrinë, që kishte dimëruarë ndë ujdhesët, **e cila kishte** shënjë të Dhioskurëvet. ¹² Edhe si arritmë ndë Syrakusë, mbetmë **atje** tri dit. ¹³ Edhe që andej dyke ardhurë rrotullë arritmë ndë Rigjë; edhe pas një dite passi fryti erë shiu, mbë dy dit erthmë ndë Potiollë. ¹⁴ Atje gjëtmë vëllezër, të-cilëtë na ulutnë të mbetemi ndër ata shtatë dit, edhe kështu unismë për ndë Romë. ¹⁵ Edhe që andej vëllezëritë kur dëgjuanë për ne, na duallnë përpara gjer ndë Trekt t'Appiut e gjer ndë Tri Tavernat; të-cilëtë kur i pa Pavli, i ufal ndersë Perëndisë, edhe mori zëmërë.

¹⁶ Edhe kur erthmë ndë Romë, kryeqindësi dha të-lidhuritë ndë dorët të të-parit të ushtërisë; po Pavlit i udha lejë të rrijë mbë vetëhe bashkë me ushtëtorinë që e ruante. ¹⁷ Edhe pas tri ditsh Pavli thërriti të-parët' e Judhenjet; edhe ata si

umblohtë, u thoshte atyre, O burra vëllezër, ndonëse unë s'kam bërë gjë kundër llauzit a kundër zakonëvet t'atërvet **t'anë**, më dhanë nga Jerusalemi të-lidhurë ndë duart të Romanëvet; ¹⁸ Të-cilëtë si më pyetnë, deshnë të më lëshoninë, sepse s'kishte asndonjë ngajë për vdekje tek unë. ¹⁹ Po passi Judhenjtë flisninë kundërë, ushtrënguashë të thërres mbë Qesarinë, jo se kam për të përfolurë mbë gjë kombinë t'im. ²⁰ Për këtë punë pra u thirra juve, që t'u shoh e t'u flas; sepse për shpresën' e Israilit jam lidhurë me këtë vark hekurash.

²¹ Edhe ata i thanë, Neve as kartëra kemi marrë për ty nga Judhea, as erdhi ndonjë nga vëllezëritë të dëftenjë a të flasë gjë të-keqe për ty. ²² Po duamë të dëgjojmë prej teje ç'ke ndër mëntt; sepse për këtë sektë neve dimë se kudo kundërëllitetë.

²³ Edhe passi i ndanë ati një ditë, erthnë shumë **veta** tek ay atje ku kishte rënë; të-cilëvet ay u dëftente me dëshmime mbretërin' e Perëndisë, dyke mbushurë atyre mëndjenë për punët' e Jisujt edhe nga nom i Moisiut edhe nga profitëritë, që ndë mëngjest e gjer mbrëmanet. ²⁴ Edhe ca bindeshinë mb'ato që u thoshte, po të-tjerë nukë zininë besë. ²⁵ Edhe si nuk' ishinë mbë një fjalë ndër mest të tyre, ikninë, passi tha Pavli një fjalë, Se mirë u foli Frym' e-Shënjtëruarë atërvet t'anë me anë të profitit Isai, ²⁶ Dyke thënë, "Shko te ky llaus edhe thua, Me të-dëgjuarë dotë dëgjoni, e nukë dotë merrni vesh; edhe dyke parë dotë shihni, e nukë dotë kupë-toni; ²⁷ Sepse utrash zëmër' e këti llauzi, edhe me veshëtë dëgjuanë rëndë, edhe syt' e tyre i mbyllnë; semos ndonjë herë shohënë me sytë, e dëgjonjënë me veshëtë, e kupëtonjënë me zëmërrënë, edhe kthenenë, e i shëronj ata." ²⁸ Letë jetë pra e-diturë mbë ju, se shpëtim' i Perëndisë udërgua mbë kombetë; ata edhe dot'a dëgjonjënë. ²⁹ Edhe si tha këto, Judhenjtë iknë, dyke ngrënë me shumë fjalë njëri me tjetërinë.

³⁰ Edhe Pavli mbeti dy vjet të-tërë ndë një shtëpi të-veçantë me të-paguarë; edhe priste gjith' ata që vininë tek ay, ³¹ Dyke lëçiturë mbretërin' e Perëndisë, e dyke mësuarë **njerëzet** ato punëra që kishinë të bëninë me Zotinë Jisu Krisht, me çdo kuxim e pa ndalim.